

Si poet, Ervin Hatibi debutoi me librin "Përditë shoh qiellin" kur ishte akoma gjimnazist, 15 vjeç. Libri tërhoqi shumë vëmendjen e lexuesve dhe kritikës, edhe ngaqë parathënien e tij e përgatiti Ismail Kadare duke e quajtur autorin, mes të tjerash, si pararendës të një aradhe të re poetësh.

Pas një mungese të gjatë, ai rikthehet me një libër me poezi të titulluar "Transkript nga krevati tjetër". Me sa duket, Poeti zbret sërish nga Toka e Poetëve - Parnasi - në tokën e lexuesve, zbritje që shënjohe pikërisht nga ky libër.

ERVIN HATIBI: Këto nuk janë fjalët e mia!

Bashkëbisedoi Andreas Dushi



**"PASQYRA E TË
RRËFYERIT" E RAMADAN
MUSLIUT – DËSHMI
E MIRËFILLTË E POETIT
TË MADH**

(fq. 10)

nga Anton Nikë Berisha

*Shënime për librin "Vargmale nën dhë",
të poetes Nurie Emrullai*

"PLAKEN ZOGJTË..."

nga Virion Graçi

(fq. 9)

Jetojmë mes letrarësh e lajmëtarësh letrarë, por deri para ca ditësh, po të pyeste dikush për emrat e dalluar në poezinë bashkëkohore shqipe, emrin Nurie Emrullai nuk do ta kisha shqiptuar; nuk do ta kisha përmendur sepse nuk e njihja poezinë e saj.

*(Një shikim mbi librin "Fëmija i
dritës- Edhe një herë për lumin" të
Enton Bidos, botime Jozef, 2020)*

**MES POEZISË DHE
PROZËS... NJË LIBËR I RI**

nga Fatmir Minguli

(fq. 8)

G. G. Márquez

TREGIM PAS TREGIMIT

Klotilde Armenta, që është një nga personazhet e romanit tim "Kronikë e një vrasje të paralajmëruar", në një pjesë të librit thërret papritur: "O perëndia ime! Sa të vetmuara jemi ne gratë në këtë botë!"

(fq. 17)



KATËR VINJETE NË MBROJTJE TË POEZISË

Rudolf Marku (Poet Laurat)

(fq. 6)

Para disa ditësh, një kanal Televiziv Shtetëror organizoi një gjygj për Poezinë e para viteve '90 të shekullit të kaluar.

Pak a shumë u tha se ai që u shpall Poet Laurat nuk duhet të shpallej i tillë, për shkak se ka shkruar një poezi për Partinë. U tha se Poezia e para viteve '90 duhet gjykuar rreptësisht me parametrat revolucionare-demokratike të antikomunizmit të sotëm.

MARGARET ATWOOD

**Distopia e harruar që frymëzoi
George Orwell-in dhe mua**

The Telegraph, 4 nëntor 2020



(fq. 18)

BIBLIOTEKË

Julian Barnes

Një për çdo lloj

(fq. 14)

Nuhi Sadiku

Terri është qefini im

(fq. 12)

Illir Belliu

Gjithë zogjtë e botës

(fq. 13)

**"KUR ËSHTË FJALA
PËR KOMBIN E VET,
KADAREJA ËSHTË PO AQ
I VERBËR SA HOMERI"**

*Keqkuptimi i kritikut francez për
romanin "Dosja H"*

nga Skënder KARRIQI

(fq. 17)

Si poet, Ervin Hatibi debutoi me librin "Përditë shoh qiellin" kur ishte akoma gjimnazist, 15 vjeç. Libri tërhoqi shumë vëmendjen e lexuesve dhe kritikës, edhe ngaqë parathënien e tij e përgatiti Ismail Kadare duke e quajtur autorin, mes të tjerash, si pararendës të një aradhe të re poetësh.

Pas një mungese të gjatë, ai rikthehet me një libër me poezi të titulluar "Transkript nga krevati tjetër". Me sa duket, Poeti zbret sërish nga Toka e Poetëve - Parnasi - në tokën e lexuesve, zbritje që shënjohe pikërisht nga ky libër.

ERVIN HATIBI: Këto nuk janë fjalët e mia!


Bashkëbisedoi Andreas Dushi

A.D: Z. Ervin, është kënaqësi e veçantë kjo bisedë me ju, një person që brezi im ju sheh si i ardhur nga një realitet paralel: Sikur keni zbritur nga Parnasi me autobuz, kur ishit pesëmbëdhjetë vjeç, për të qëndruar më shumë se një dekadë, gjatë së cilës krijuat një poezi krejt të veçantë, e pastaj u larguat prap, me Pegasusin tuaj në ndenjësën ngjitur. Si e kujtoni atë periudhë kur ishit aktiv jo vetëm në poezi e letërsi, por edhe në media me esse apo opinione për çështje të ndryshme?

E.H: Po pyes ndërkaq veten në jam i detyruar ta saktësoj këtë pikturë kaq të bukur e të pamerituar ku më keni vendosur dhe përgjigjja më vjen prapë me pyetje: po pse? Më pëlqen mes malit e kalit, Parnasit e Pegasit. Zbritjen parnasjane që përmendni më duhet ta justifikoj në CV duke nënkuptuar me të zbritjen e përditshme, formative, nga fëmijëria e përtej, të vështirimit e ndoshta shpirtit, prej shpatullave të kaltra të Dajtit, kupolës që na përbashkonte në qytet, vështirim që zbriste duke mirëmbajtur e lëmuar në vite konturet identifikuese të Malit, kriterit tim, deri ditën kur e murosën pa frymë pas pallatesh, për ta thërmuar kështu qytetin. Ikja e Dajtit i korrespondon me saktësi edhe ikjes sime e të kaq shumë e shumë të tjerëve si unë, qoftë dhe pa hedhur një hap larg qytetit, meqë ikja e Dajtit e mori me vete, për fare. Formaliteti i ikjes saktësohet, pastaj, maksimalisht, bashkë me adresën time të më shumë se një dekadë, përmes emrit të njohur që përmendët, "Pegasus", të një kompanie turke të fluturimeve *low-cost*.

Për të përmendur ikjen nga publiku apo qyteti, më duhet të përmend më shumë se kaq dhe ikjen nga vargjet. Meqë familjarizimi me stilin tim më turbullon e më largon vetiu nga shkrimi i vargjeve për aq kohë sa ta harroj e ta mësoj nga e para shkrimin dhe një herë tjetër, pak a shumë si krijesat që zhvoshkin lëkurën e vet, gjer sa t'iu formohet e reja. Kështu çdo libër është një lëkurë e zhveshur gjarpëri, në pritje të dalë tjetra. Sa ia mbërrij pastaj ndryshimit, ky është diskutim i hapur, por rrugë tjetër s'kam gjetur, e as që kam kërkuar, gjërat ndodhin vetë. Kurse në lloje të tjera të pranisë së shkruar nuk besoj të kem munguar ndonjëherë. Vendet ku botoj ato ç'ka shkruaj janë disi mënjane (po ku qenka qendra sot?) prandaj dhe duket se kam

ikur krejt, e për mua më shumë se ikje më tepër është çështje labirinti: jam po aty por nuk duket, murosur pas vetëm një tjetër blloku pallatesh të freskët - ose mbi Dajt. Shkruaj rregullisht për revista e periodikë, me kushtin, së paku deri më sot të pashkelur, të botoj vetëm mbi letër, meqë besoj se letrat kanë përherë adresë, e ngushtojnë komunikimin deri afër formatit të shkruarit, i cili përherë e ka një adresë lexuesi në kokë kur shkruan, sado të pasaktë. Prandaj në ekuivalentin elektronik të revistave ku shkruaj, përherë mungojnë tekstet e mia dhe ndoshta fakti që nuk klikohem dot në ekran, bën të dukem se s'jam; kur vetëm sa thjesht nuk po mësohem dot me kaq shumë ndryshime në kaq pak vite, ndryshime në teknologji e zakone me



të cilat nuk kam ditur të përballem dot përherë mirë prandaj vazhdoj të këmbëngul në vertikalitetin e vjetër të komunikimit, në konspiracionin e krijimit të letrës me vlerë, në përballjen me lexuesin formalisht të iniciuar, që mirëmban distancat përmes pagesës apo heshtjes – nëse do ta vendosja këtë si krahasim me horizontalitetin vicioz të komunikimit nëpër panoptikonet e mitingjeve *“online”* ku masa ul e ngre gishtin blu për jetën a vdekjen tënde virtuale, në rastin më të mirë. (Në kulturën tonë kemi mbetur pa ndjekur sa duhet shembullin fetar të Mujit dhe Halilit që vendosën të ngujoheshin në shpellë, fill sapo u shpik arma e zjarrit, meqë dinjiteti e donte të mos humbnin betejën pa meritë në një lojë klikimesh nga larg.)

A.D: Ju hytë në letërsi, sikurse në një shkrim për ju lexova, si një “eksperiment”, me vëllimin poetik “Përditë shoh qiellin”, botuar kur akoma ishit gjimnazist. Si e kujtoni këtë “hyrje” tuajën, nëpërmjet portës së duhur, sikurse thotë Kadare në parathënien e këtij libri?

E.H: Libri i parë ishte mbështjellë me të kaltër, kushtëzuar prej titullit. Kopertina e punuar nga piktori Sali Allmuça, daja dhe mjeshtri im i parë, hapej me një dritare në qiell dhe kjo dritare besoj është dhe dera nga kam hyrë në këto punë. Në një kuptim, kjo dritare ishte parathënia e Kadaresë, pa të cilën libri i një pesëmbëdhjetëvjeçari, shkruar nga një trembëdhjetë e katërmëdhjetëvjeçar, do vazhdonte të rritej edhe kush e di sa kohë para dyerve hezituese të Shtëpisë Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, viti 1989. Poetin Ilirjan Zhupa, përgatitësin e librit, po ashtu nuk harroj asnjëherë ta falënderoj. Ka qenë nga të parët që ka besuar tek vjershat e një thuajse-fëmije e t'ia kalojë ato për lexim dhe Kadaresë: nuk besoj të kem bërë ndonjëherë për veten diç më të guximshme se ai kalim i bllokut tim me vjersha nga dora e Ilirjanit në atë të Ismailit. As sot s'do guxoja ta bëj.

A.D: Për të qëndruar po tek ai libër, po tek ajo parathënie, në fund Kadare shkruan “Prandaj, mirëseardhja për autorin e ri të këtij libri, le të jetë mirëseardhje për gjithë aradhën e re.” A u ndjetë “i mirëseardhur” në realitetin letrar të asaj kohe?

E.H: Pa asnjë diskutim. Dhe falemnderit që përmendni “aradhën” e paralajmëruar nga Kadareja, pse ajo e bën parathënien të dalë nga thjesht libri im i parë e të marrë një rol historik, tej emrave të përveçëm, rol që s'di pse nuk ia njohin ata që shkruajnë për letërsi a poezi të viteve 1990', apo brez të nëntëdhjetës. Duket e lehtë, evidente sot të flitet për identitetin e prurjes letrare që nuk kishte si të mos shpërthente – shkak-pasojë gati mekanike - pikërisht në po ato fillim-vitesh 1990 të lirisë; por puna është se Ismail Kadareja përshkroi shprehimisht një valë letrare të viteve 1990', që në verë të 1989-s. Më vjen keq që nuk e kam bërë vetë më parë, por po e regjistroj këtu si dëshmi. Kadareja rreshton në një lloj skice tri valët që kishin kaluar përmbi letërsinë shqipe të pasluftës së Dytë, me një cikël plotësimi prej pesëmbëdhjetë vitesh mes njëra-tjetrës. *“Vala e parë, - shkruan - që erdhi fill pas Çlirimit e me të cilën u bashkuan shkrimtarë që shkruanin edhe më parë (për fat të keq jo më të shquarit), krijoi shtresën e parë të letërsisë së tanishme, me sukseset por edhe me mungesa të ndjeshme. Pesëmbëdhjetë vjet më vonë, në fillim të viteve '60, një valë e re shkrimtarësh hyri vrullshëm në letërsi bashkë me një epokë plot shqetësime. Duhet thënë se megjithatë mjaft shkrimtarë, ndonëse mosha i bashkonte me këtë valë të re, vazhduan e vazhdojnë ende të kenë afinitet me letërsinë e valës së parë. Në mesin e viteve '70, pra përsëri pas pesëmbëdhjetë vjetësh, në letërsinë tonë nisi një valë e re. Për çudi, edhe këta më shumë se me valën paraardhëse, patën afinitet me valën e parë, çka shpjegon dhe një vizion jo të gjerë sa ç'duhet të botës dhe kufizime e mungesa të ngjashme me ato të fillimeve të letërsisë së re. Jemi në fillim të viteve*

nëntëdhjetë (pra kanë kaluar prapë pesëmbëdhjetë vjet),
veç kurrresi për një simetri kabalistike, por sepse ndihet
vërtet nevoja, në letërsinë tonë pritet ardhja e një vale
të katërt.”

A.D: Po fakti se jeni pararendës i asaj “aradhe të re”
që vijon akoma të befasojë, si ju bën të ndiheni?

E.H: Në fakt, për t’iu kthyer fjalës së Kadaresë i bie
që “aradha e nëntëdhjetës”, “vala e katërt” (*nouvelle
vague*) të jetë pararendësja ime, dhe unë thjesht t’i jem
bindur një ritmi të parezistueshëm duke iu bashkuar,
si pjesë e paracaktuar e saj. Si ajo skena e famshme e
demonstratës të “Kohët moderne” të Charlie Chaplin-
it, ku virtyti i vetëm i protagonistit, virtyt për të cilin
më pas dhe e arrestojnë, është veç kthesa urbanistike
që merr rruga për t’i bashkëngjitur atij nga pas një
demonstratë të gatshme.

A.D: Ndërkohë, riktheheni me një libër me poezi
pas shumë vitesh. Ç’ju shtyu ta merrni këtë vendim
pikërisht tani?

E.H: Interesante është se edhe gjatë këtyre viteve
zyrtarisht pa botuar, poezi të reja me emrin tim kanë
dalë periodikisht në qarkullim, flas për sa kam mundur
të has në faqe gazetash letrare interneti. Si thotë gjatë
një interviste tashmë virale një qytetar i Kosovës, të
cilit i kishin vjedhur votën (“*Ma kanë votu’ votën!*”), kam
parë dhe unë në vite, shpesh me një lloj kënaqësie, sesi
ma kanë shkruar poezinë bota, e ma kanë shumëfishuar
pastaj nëpër internet. Të prek fakti që dikush, individ
a komitet, për gallatë a me seriozitet, ka marrë frymë
thellë e ka vendosur të mbushë mungesën time me
vargje në publik, qofshin ato dhe parodi sarkastike.
Dhe kur sajojnë një, s’ka gjë, por më shumë bëhet
vërtet shumë, aq sa kupton pastaj që do marrë pak
nën kontroll situata; dhe sikur vetëm kjo urgjencë do
të mjaftonte për të kuptuar se është mbushur kupa,
toka i takon atij që e punon: “publiku” ka marrë peng
poetin: ka ardhur koha për libër të ri.

Homazh për përshtatësit, hartuesit apo birësuesit e
poezive të Ervin Hatibit, me tituj si “*Mesnatë në bregdet*”,
ku më duhet të admiroj një hapje klasike timen, si prej
shahisti, me zbritje traumatike muzgu, apo neonë, nga
ata që puliten ngjirrur motelesh amerikane në jo pak
poezi të miat:

*Neonët e qytetit
vjellin dritë
mbi sipërfaqen e qetë
të detit.
Era edhe flladin diku e harroi...
Gjethet kanë ngrirë,
si veshë të nderur në përgjim etj., etj..*

E kam marrë dhe si kritikë, mjaft me muzgje e terr,
meqë jo pak poezi të miat zhvillohen mbi një sfond të
gatshëm errësie qytetëse, gati laboratorike. Por edhe
këtë kritikë është treguar më i shpejtë dhe e ka pranuar
po në emrin tim tjetërkush: ky ose kjo ka shkruar një
poezi të re timen për mëngjesin me diell, ndoshta në
stilin më të mirë të librit tim të parë:

*U zgjova me asnjë re në kokë,
Është imi dhe i askujt tjetër, mëngjezi!
Ti diell vazhdo rrotullimin nëpër botë,
Ju zilet e orave është mirë të heshtni!*

Po të mos kisha botuar librin që sapo doli, sinqerisht,
plan kam pasur (dhe ende e kam) të botoj një antologji
me poezi të miat, shkruar nga të tjerë. Mund të gjej
ndonjë galerist a botues të më mbështeste. E nëse
duket se ekzagjeroj, po them vetëm se veç këtyre që
përmenda lart, kam plot faqe libri për të mbushur
me të gjitha tekstet e grupit Ritfolk që qarkullojnë



ervin hatibi

transkript nga krevati tjetër

OnufriPoezi

masivisht nën emrin tim. (Kur në fakt, me krenari,
kam shkruar vetëm dy e gjysëm prej tyre: “Afrohu”,
“Drejt fatit tim” dhe gjysmën e parë nga “Dëshirë e
heshtje” – për seancat e gjysmës së dytë shokët e grupit
i humbën gjurmët e mia nëpër Tiranën pa celular të
atyre viteve, deri sa u kaloi afati i regjistrimit në studio,
dhe e plotësuan vetë tekstin).

A.D: Poezia juaj, edhe në librin e botuar sëfundmi,
ngjan të ketë një frymë urbane, ku ndërthuren elementë
e detaje nga përditshmëria e qytetit dhe qytetarit. Të
njëjtën gjë vërej edhe te krijimtaria e mëhershme.
Është kjo një zgjedhje, apo këtu qëndron ajo çka ju
ngacmon për të shkruar një poezi?

E.H: Më ka bërë shumë përshtypje një episod nga
kujtimet e Petraq Kolevicës me Lasgushin. “*Mbasi
mbarova fakultetin – shkruan Kolevica, - shkova ta
takoja Lasgushin, ta takoja si njeri, ta njihja. Atëherë
tek Lasgushi shkonin mjaft poetë, që t’ua lexonte poezitë*

*dhe të merrnin ndonjë mendim prej tij nëse ia vlenin
apo jo poezitë e tyre. [...] Kur vajta unë kujtoi se i kisha
dërguar poezi.*

*-Përse shkruan?, më pyeti, për bilbila apo për
traktorë?”*

Më pëlqen kaq shumë fjalia e mësipërme, brutaliteti
kriminalizues i pranëvendosjes zogj e zinxhirë
traktorësh, kjo taksonomi *hardcore* e Lasgushit, jin-
jang, binare; dhe më pëlqen t’ia fshij kontekstin e
disidencës bukolike eskapiste përndjekur lëndinave
nga brigada të motorizuara të Lidhjes së Shkrimtarëve,
që pastaj të kem mundësi të zgjedh, pa komplekse, a
të më zgjedhin si të vetin, bilbilët a traktorët. Mund të
thuash pse vallë kjo kundërshti arbitrare, anakronike,
bilbil-traktor, pse do futur vetja në një ngushticë kaq të
parehatshme zgjedhjesh; por, nëse do kërkuar ndonjë
kriter për veten, ky do gjetur përherë jashtë vetes,
në burime të pakontrollueshme dot, dhe nuk ma jep

kush në poezi më mirë këtë se Lasgushi mistik, poeti si antonomazi, autori i heshtjes aktive më poetike e shpresëdhënëse në antologjinë e performancave shqip. (Lasgushi heshtte mes traktorëve, dhe dëgjohej një cicërimë). Testi, barazlanguar mes një fjale orientale të traditës dhe një të modernizimit propagandistik, nuk është thjesht kundërshtia zë – zhurmë, varg – vrragë, lart – poshtë, frymëzim – teknikë, natyrë – kulturë, dëshirë - detyrë, *ora – labora*, shpirt – shtet, etj., etj. Në radhë të parë kundërshtia vlen të shihet dhe si këndim – shkrim, meqë traktori është veç një sofistikim në kohë i shkopit që mih tokën e Mesopotamisë për të mbjellë farën, i njëjti shkop që grish shenja mbi tabelën e baltës. Në gjithë këto kuptime poezia ime, pavarësisht maskimit me puplat e fluturimeve muzikore, sërish është poezi shkrimi, më shumë se këndimi. Do forcë të madhe, përveç dëshirës, kapërcimi i qytetit për qiellin, i shkrimit për këndimin, i shkronjës për shpirtin: unë bëj më të thjeshtën duke iu nënshtruar, tani për tani.

A.D: Në poezinë shqipe, zëri juaj është krejt i veçantë. Keni një varg plot muzikalitet e metrikë që lindin nga liria dhe falë të cilave, lexuesit i duket si të jetë duke lexuar i shtrirë mbi një re. Nga buron ky zë; nga ç'ndijime, ç'lexime...?

E.H: Shumë ju falemnderit për këto fjalë! Preokupimi me transportin përmes tingullit e ritmit ka filluar më ndjeshëm në librin e fundit, krahasuar me ca fillesa në atë para tij, dhe nuk e di mirë pse. A ka të bëjë me moshën? Me ezaurimin e modeleve? Me rebelimin pseudokonservator global? Me faktin që edhe poetë të tjerë që i vlerësoj në shqip i janë kthyer dallueshëm kësaj rruge?


Një arsye që e di mirë fillon me një tronditje që kam pësuar në vitin 1996, në autobus, përmes Tepelenës. Ndaluan autobusin e hipën me zhurmë tre të fortë vendas dhe imponuan një heshtje të sikletshme ndër spektatorë - spektatorë po them, meqë trimat transportonin filma në ecje, me gjestet e veshjet “*spaghetti-western*”. Zunë vend në rreshtin e fundit e pastaj njëri tha – A ia marrim? Nuk di kush u ndie i rrezikuar, nga shpina, sigurisht kush kishte ndonjë plaçkë që mund t'i merrej, por personazhet në fakt ia morën direkt këngës me iso. Efekti që gati i menjëhershëm; mornicat veshën autobusin, vibrimi ritmik i zërave të rimuar burrorë nënvizim pas nënvizimi përsëritës m'i transportonte si tatuazh në shpinën e kthyer figurat nga vargjet që nuk i harroj dot, që s'pata nevojë fare t'i kopjoj aty për aty.

*S'të qëllova për të vrarë
Moj kunadhja gushëbardhë
Të qëllova për të marrë
Moj kunadhja gushëbardhë*

(Vetëm një herë kam parë kunadhe, i vogël, në një kodër dëllinjash jashtë Tiranës, si u ngrit mbi dy këmbët e pasme, fshiku majtas-djathtas me vështrim e u zhdruk si fanitje. Po vetëm në Tepelenë e kuptova pse tiranasit i thonë nuse, nuselale kunadhes.

Kjo është puna me bukurinë, sapo e cakton jashtë vetes, duhet ta vuash faktin që nuk je ti bukuri, që ajo s'është pjesë e jotja, amputim i sapozbuluar; dhe ashtu si me kunadhen e pakapshme gushëbardhë, përtej detajeve të keqkuptimit ndërgjinor, bukuria me jobukurinë nuk ka gjuhë komunikimi, ka vetëm nënshtrim: t'i nënshtroresh indiferencës së saj, apo, si në versionin lab, natyrisht, të përpiqesh ta nënshtrosh, ta bësh tënden, me forcë e iso; edhe duke ditur mirë që sapo të vesh dorë në të, do të prishet, thua po ndiqje një fantazëm. Rendja për t'u plotësuar me bukurinë, për ta marrë në gushë, është sigurisht rendje drejt vdekjes.)

Asnjëherë nuk më kishte tërhequr nga ekrani kënga me iso, isha i vetëm në një rresht ulësesh, dhe m'u desh të maskoja goditjen duke mbështetur fytyrën e lagur në



sediljen para, gjasma më zu makina. Mbaj mend mirë dhe refrenin e këngës tjetër që kapën (“*o florir’ i vogël fare*”) dhe e kam riprodhuar në një tekst që kam botuar para më shumë se një dekadë, kënduan papritmas dhe një për Ismail Qemalin, po e rëndësishme është të besoj se aty, bashkë me habinë dhe tronditjen do jetë pjekur në mua dëshira për ta imituar sadopak atë lloj efekti.

A.D: Të madhe tha nëna/ Ju zemrën e keni/ Ky e ka të vogël/ Dyzet vjet me radhë/ Kujtoj këto fjalë/ Dyzet ikën vitet/ Zemra nuk po rritet. Si ka ndikuar në poezinë tuaj që zemra nuk po rritet?

E.H: Ky është një shembull i asaj që po përpiqesha të imitoja më lart, efektit të vargëzimit popullor jugor. Nuk e komentoj poezinë time, po vetëm po them se bëhet fjalë për një ngjarje-nyje nga fëmijëria e parë, nga një takim i përafërt si ky me kunadhen gushëbardhë në autobus, zemrën e së cilës e ndjeja si rrihte gjithnjë e më pak në shpinën time, në Tepelenë.

A.D: dallimi është se unë nuk ec’, unë/ e përkëdhel k’të qytet/ balt’ e asfalt/ mes plagësh të tij me qelb cek butë/ ndoshta shërohem vërtet (ndopak). Keni menduar të ktheheni për të “përkëdhelur” me ecje Tiranën sërish?

E.H: Tani që po nis të shkruaj këtë përgjigje, vura re se fjala “plagë” e lidh këtë poezi me vargun ndoshta më të madh të Seferisit, meqë jo vetëm atë, po edhe të gjithë ne na plagos Greqia madhështore kudo

që shkojmë, plus atdheut – greku pati fat, atdhetë i përputheshin. Si kolonët a themeluesit kur emërtojnë tokën ku ngulen me emrin e vendit të origjinës që mezi e kujtojnë (New Amsterdam a New York?), unë çdo qytet jashtë timit e shpall Tiranë të Vjetër. Pasi e kam të pamundur të mos mbivesh në kënde a situata pamje që ma kujtojnë kudo Tiranën: ja një rrugë me të njëjtën vjeshtë si Rruga e Liceut, ja një kolonë zanore dhe arome si Tek Biçikletaxhiu bri kinema “17 nëntorit”, ja një det, si Lana, që ndan përmes një qytet; kurse vetëm në Tiranë Rruga e Liceut nuk i ngjan Rrugës së Liceut, për dallim. Vendet që më kanë rritur nuk ekzistojnë më fare dhe tashmë Tiranën e mbaj si ato kartmonedhat përgjysëm në filma me spiunazh: që ta rindërtoj, më duhet patjetër një vend i huaj ku të puq gjysmën tjetër të asaj kartmonedhe dalë nga qarkullimi.

A.D: Në librin e sapobotuar, keni një poezi: *Vdekja e metaforës*. Kush apo çfarë e vret/ vrau metaforën?

E.H: Poezia bën fjalë për një poet të cilit i rri ngushtë muri i metaforës, i cili dhe e ndan nga poetët e tjerë. Vetëm poeti mundet ta vrasë metaforën, duke e përjetuar deri në vdekjen e sigurt.

A.D: Në *Pasqyra e lëndës*, bëni një lojë të këndshme me poezinë *Edhe një herë mbi çmimin e bananeve*, duke e paraqitur në pesë variante të ngjashme, ku, përveç pak fjalëve të reja, secili variant luan me fjalët e variantit pararendës, duke u ndryshuar rendin e vendin. Ndërsa

te *Transkripti nga krevati tjetër*, tentoni ta grisni një poemë nga arkivi me titull (*Në një dhomë ndodhej dikur një njeri që nuk shihej nga askush*). Pse kjo “lojë” apo “grisje” e asaj çfarë shkruani?

E.H: Me banananet, kam bërë, si të thuash, pesë stampime të ndryshme të së njëjtës poezi dhe njërën prej tyre ia kam lënë ta miksojë me fjalët e veta një shokut tim, poetit Dritan Xhelo (“*d.j. remix*” e kam nëntitulluar variantin e tij). Transkripti që në titullin e librit e çon këtë teknikë tjetërkund, duke riprodhuar në vargje zëra që nuk më janë shlyer dot nga kujtesa, në vite. Edhe grisjet (*décollage*) nga arkiva, përveçse adaptim nga artet plastike, si tek serigrafia me banane, janë pjesë e po asaj tentative që poezia të jetë e parashkruar më shumë se e shkruar, vargun ta gjej më shumë se ta kërkoj, ta ricikloj më shumë se ta krijoj, në shenjë nderimi e mirëbesimi për atë që ekziston e pakontrollueshme jashtë meje.

A.D: Si bëhet *transkripti nga krevati tjetër*? Pse pikërisht ky titull për këtë libër?

E.H: Krevati tjetër tregon vetiu se ekziston të paktën dhe një krevat origjinal, si minimum, dhe mundësia që në titull hapet për një socializim krevatesh, nga vëllazëria në heterotopi a pandemi, nga burgu a konvikti, kapanoni, te hosteli a morgu, ku njësuar nën të njëjtat mbulesa, gjithkush është njëri ose tjetri, i gjalli ose i vdekuri, i analizuari o analisti, dëshmia a dëshmuesi: transkripti mund t’i mvishet kujtdo, nga krevati tjetër.

Fillimisht librin e kisha titulluar “*Zjarri i madh Selanikut*”, pastaj “*Dora e poetit*” (për shkak të asaj këmbës foshnjore fotografuar në kopertinë), pastaj “*Leni*” – shkurtim i një titulli poezie, pastaj vendosa për një fjali shkëputur nga një raport policor. Disa ditë para se të çoja librin në botim, zgjodha dhe titullin përfundimtar, prej një poezie të librit. Titulli është ky që është meqë në fjalën “*transkript*” përmbante një si përshkrim teknike apo gjinie, kurse fjala “*krevat*” mbetej si një shenjë kalendarike spitali për vitin 2020.

A.D: Thonë se nuk ka gjëkund i një sirtar aq të madh sa t’i zërë ëndrrat. Këto poezi të ëndërrta që janë përmbledhur në këtë libër, ku kanë qëndruar, apo janë shkruar sëfundmi?

E.H: Transkripti në rastin e këtyre poezive, bëhet përmes kujtesës, ndihmuar nga ëndrrat, prandaj dhe sikur ndodh në krevat. Kur fiken dritat, drita merr me vete dhe muret, gjithë krevatet flenë bri njëri-tjetrit, brenda një figure të rregullt gjeometrike. Poezitë kanë përfunduar së shkruari në nëntor të vitit të kaluar.

A.D: Sa kohë i kushtoni ripunimit të një poezie, para se ta botoni për t’ia paraqitur lexuesit?


E.H: Këto poezi i kam lënë të hapura me muaj rresht, pasi nuk i shkruaja në letër e nuk dija si t’i mbyllja. Kur shkruaja me bojë, poezitë mbylleshin brenda një tharje boje.

A.D: Po lexuesin e *Transkript nga krevati tjetër*, si e mendoni?

E.H: Dikush në krevatin tjetër, të cilit po i diktoj fjalët e mia, besnikërisht.


A.D: Në një intervistë të dhënë më 9 janar 2001 në gazetën *Albania*, thoni: *Poezia ka hyrë si një virus në gjakun tim*. Cili është sot raporti juaj me poezinë?

E.H: Kur më vihen përpara fjalë të miat, ndonjëherë dhe vargje, shpesh ndjem njëlloj si ata bashkëpunëtorët e Sigurimit të Shtetit, kur i ballafaqojnë me paragrafe spiunimi në copa të vjetra



dokumentesh, riprodhuar mijëra kopje në gazeta. Para fjalëve që më atribuon arkiva, më vjen të fshihem dhe unë, i skuqur si ata, pas formulave standard të mbrojtjes: “Ashtu ishte sistemi!”, “Isha i ri, më detyruan!”, “Fjalët janë nxjerrë nga konteksti”, deri dhe: “Këto nuk janë fjalët e mia!” - çka mund të jetë dhe rasti në fjalë, nuk do ishte hera e dytë. Gjithsesi, në këto kohë vrastare virusesh merr kuptim dhe lufta ime e madhe, meqë kam botuar vetëm katër libra poezie në katër dekada e gjysëm jetë.

A.D: Libri juaj me pop-eseistikë, *Republic of Albania*, botuar në vitin 2005 nga *Ora*, ka një ese të titulluar *Etja për qytet*, etje që ndihet në Tiranë. Sot, kur nuk jetoni më në këtë qytet, a është shuar ajo?



E.H: Sipas suksesit konsensual në shekuj të asaj fabulës me miun e qytetit dhe miun e fushës duhet të kisha mbërritur më në fund dhe unë në një moshë veljeje, deri vjelljeje me qytetin, ta denoncoja burgun, por ende jam i etur, nuk e kam mbërritur ende dot cakun çlirues pas të cilit fillojnë fushat.

A.D: Për të qëndruar pak këtu: Poezia juaj njihet gjerësisht, por ndërkohë keni shkruar edhe eseistikë, librin e përmendur më lart si dhe *Një gjarpër i viteve gjashtëdhjetë dhe të tjera tregime zoologjike*, botuar në vitin 2018. Ishte nevojë e brendshme të shpreheshit në këtë mënyrë, apo ju nxiti ndonjë tjetër arsye?

E.H: Bëhet fjalë për koleksion tekstesh hibride, rreth kafshëve. Konvencionalisht një tip të tillë shkrimi e quajnë esse, dhe ashtu qoftë, në çdo rast është praktikë që ndonjëherë më pëlqen po aq sa poezia. Më pëlqen kur një tekst fillon si pamflet, korruptohet ritmikisht, kalon përmes zhargonit akademik e mbaron në memuaristikë a fksion. Po të mos ishte temp*i rock n’ roll* që ma kronometron mërzinë a entuziazmin, ndoshta do duhej të shkruaja tekste shumë më të gjata në këtë teknikë. Po siç shihet dhe nga kjo intervistë, përgjigjet e së cilës sa vijnë e shkurtohen, nuk duket se është sport për mua – ende.

A.D: Përveçse si poet dhe eseist, ju përmendeni edhe si piktor. A vazhdoni të pikturoni dhe si është raporti mes letërsisë dhe pikturës brenda asaj pjese ku mbrujtet arti, krijimtaria juaj?

E.H: Ai titulli i filmit të Wody Allen, “Whatever works”, mund të shkruhej si moto në punishten time: çka më pëlqen e mundem t’ia dal - do ta bëj – poezi qoftë a tjetërsend. Me bojë nuk i kam maskuar prej ca kohësh duart.

A.D: Ndonëse lexuesi, sidomos ai i ri në moshë, ju lexon dhe pëlqen shumë, ju jeni tërhequr nga jeta publike dhe për shumë vite, keni qëndruar i tërhequr edhe nga ajo letrare. Pse?

E.H: Jeta publike, reduktuar gati tërësisht në variantin e vet mediatik, keqkuptohet më së shumti si privilegj i një lloji të re aristokracie, aristokraci e brishtë elektrike parazitare që gjallon si një grusht fluturash nate në përplasje të padhimbshme para ekraneve. Do të mjaftonte vetëm një shuarje e ekranit që kjo aristokraci të shuhej, kjo aristokraci mes ekranit e publikut, po ja që ekrani është ai i makinës që mban me oksigjen publikun. Imagjino një të plagosur që heq prej kaq dekadash dhe rreth shtratit të tij, nën prozhektorë, sillen vërdallë prej vitesh komentatorë mjeksorë me ekspertiza kontradiktore, lidh e zgjidh fashot, ulëriji shoku-shokut, zhyt gishtat në plagë për të kontestuar nivelin e thellësisë që sapo ka raportuar kolegu: plagët do të vazhdojnë të mos mbyllen, as spektakli, deri sa të mbyllë sytë përfundimisht i plagosuri – spektatori.

A.D: Cila është marrëdhënia juaj me letërsinë e sotme shqipe?

E.H: Jam një lexues i implikuar seriozisht me poezinë e re shqipe. Më duket se kam, përveç kënaqësisë, detyrën magjike të lexoj sa më shumë poezi shqipe, a thua se simetrikisht pastaj këtë do ta bëjnë dhe të tjerët si unë, ndoshta dhe me poezinë time. Mezi frenoj veten të këndellem duke hedhur këtu si fishekzjarrë emra të dashur poetësh që më pëlqejnë, po lista është vërtet e gjatë dhe listat e gjata nuk kënaqin askënd – as mua – kur rreshtohesh e numërohesh e ndoshta pret të gjesh veten në numrat që zbresin, gjersa anija kozmike niset pa ty. Ndonjëri, e ndjej që po më lexon këtu.

A.D: Ju falenderoj shumë, singërisht për bashkëbisedimin!

KATËR VINJETE NË MBROJTJE TË POEZISË

Rudolf Marku (Poet Laurat)

1.

Para disa ditësh, një kanal Televiziv Shtetëror organizoi një gjygj për Poezinë e para viteve '90 të shekullit të kaluar.

Pak a shumë u tha se ai që u shpall Poet Laurat nuk duhet të shpallej i tillë, për shkak se ka shkruar një poezi për Partinë. U tha se Poezia e para viteve '90 duhet gjykuar rreptësisht me parametrat revolucionare-demokratike të antikomunizmit të sotëm. U vunë në dyshim dhe akademiku dhe studjuesi i njohur, Profesor dhe Studjues letersie i një Universiteti prestigjioz amerikan, i mirënjohuri Gëzim Basha, me ca pretenca shkencore zhdanoviste të Kasolles së Galigatit. U shanë pa censurë poetë dhe personalitete të letersisë bashkëkohore. U tha se ata që kanë lindur para viteve '90 duhej të mos kishin lindur hiç, për hir të letersisë së revolucionit të sotëm demokratik... Siç shihet, njëra nga ato netët e Valpurgjisë për të cilat flet Gëte te Fausti i vet.

Vetë moderatorja, Elsa Demo për fat të keq, qe në krye të Valles së Shtrigave (Nata e Valpurgjisë është Valle Shtrigash)...Ca shpirtëra të shqetësuar nga ca ligësi të pakontrolluara, qenë ftuar në këtë Gosti të dyshimtë. Një Infermjer fizioterapist, Lizard Kola -që prezantohej si professor, imitonte Vishinskin.

Ironia qe se ky program transmetohej në një kanal televiz shtetëror (RTSH2)- paguar nga taksapaguesit shqiptarë.

Një tjetër e Klubit të Beqareshave të pasukses-shme – ardhur nga vetë Atdheu i Gëtes, dhe që banon realisht pranë Pyllit të Valpurgjisë,- donte të provonte se sa gabim është vetë praktika e njohur në botë e zgjedhjes së Poetit Laurat. Vetë programi qe ndërtuar në mënyrën më komode për ata që shanin- në emision nuk qe ftuar as dhe një njëri i vetëm nga ata që shaheshin dhe përbalteshin, duke shkelur kështu dhe etiken më elementare të debatit. Qe si një karikaturë e një ndeshje boksi ku një një djalosh vrarëlije dhe kockëdalë i tundt në ring ca grushte të vegjël fëmijësh të kequshqyer një kundërshtari që nuk është i pranishëm në ring, me shpresen se do të shpallet kampion!

Nuk do të merrnja mundimit për të shkruar për këtë

incident të turpshëm, nëse nuk ka dhe nuk ka patur dhe artikulime të njerëzve të tjerë të urrejtjes kundër gjithë asaj që është shkruar tek ne para viteve '90. Për fat të keq, tek tuk dhe nga vetë ndonjë shkrimtar.

Mendoj se Letersia dhe sidomos Poezia kërkon së pari një respect të madh, si çdo krijimtari shpirtërore dhe intelektuale, para se të gjykohet. Më vjen ndërmend eruditi francez Pol Valery i cili kishte zakon të thosh se, përpara se të filloj të flas për letersinë, në fillim kërkoj të falur.

I mendoni këta gjygtarë të rreptë po të kishin jetuar në vitet para '90-s. Energjia negative e urrejtjes që kanë dhe në kushte e lirisë, zgjedhja vullnetare në kushtet e lirisë së sotme, e profesionit të Prokurorit vrasës të Poezisë, nuk i lë asnjë dyshim llogjikës së esëllt, se në krahun e kujt do të kishin qënë rreshtuar. Fakti që edhe sot duan ta gjykojnë Poezinë dhe letersinë me kritere ideologjike, pa asnje referencë estetike dhe formale, fakti se krijimtaria letrare për to është thjesht tema, fakti se nuk janë në gjëndje të bëjnë as dhe një analizë të tekstit - tregon se sa të suksesshëm do të kishin qënë vetë ata njëherë e një kohë, në karrierën e skuadroneve të urrejtjes së mendimit të lirë.

2.

Duke shfletuar keto ditë në Biblioteken Kombëtare shtypin letrar të viteve 1971 dhe 1972, (“Zeri i Rinisë,”) lexoj me respect fillimet e krijmatarisë së një brezi shkrimtarësh-Poezitë e Frederik Reshpes, Xhevair Spahiut, Ndoc Gjetjes , Bardhyl London, Natasha Lakos, Faslli Halitit, Sadik Bejkos, Sulejman Matos, Roland Gjozes, Betim Muços, Beatrice Balliut, Hiqmet Meçes, Iliriana Sulkuqit, Viktor Qurkut (nga Viktori i ndjerë lexoj një poezi të bukur dashurie ‘Kujtimi i një mbrëmje,), poezitë e Visat Zhitit, Bujar Xhaferit, poezitë e Skender Buçpapës dhe të Hamit Alisë e të Agim Spahiut -si dhe tregimet e para të Faik Ballances, Zija Çeles – ja tregimi shumë i njohur i Zijait ‘Galabuni,-tregimet lirike gjithë poezi dhe mirësi të Nasi Leres, si dhe tregimet aq premtuese të

3.

Pleniumi i Katert i KQ- Pranverë 1974.

Ka shumë të rinj që nuk e kanë idenë së çfarë do të thotë fjala Plenium. Po e spjegoj me një humor të asaj kohe që ne e thonim mes miqsh: Një francez, amerikan dhe shqiptar ecin mes xhunglës. Befas rrethohen nga një fis kanibalësh. Që të mbesni gjallë- u thotë kryetari i Fisit- duhet që të na bëni një pyetje, kuptimin e së cilës ne nuk do ta dijmë. Në rast të kundërt, do ju hamë.

--Fillojmë nga ti- i thone Francezit. Francezi thotë- Çfarë është Enciklopedia? Kanibalët mblidhen rrotull, u bien daulleve, kercejnë, derisa Kryetari thotë- Është një libër që shpjegon gjithçka. Francezin e pjekin dhe e hanë.

- E ke rradhën ti- i thonë Amerikanit. Ai- Çfarë është një raketë kozmike? Kanibalët përsëri mblidhen rrotull, u bien daulleve, kërcejnë derisa Kryetari i tyre thotë- Është një makinë fluturuese që ekslporon planetet e panjohur! E pjekin dhe e hanë dhe amerikanin.

- Është rradhë yte- i thonë shqiptarit. Ai : Ç’është një Plenium? Kanibalët mblidhen rrotull, u bien daulleve, kercejnë , prape daulleve, kërcejne, kercejne derisa Kryetari thotë- Ti shpëtove. Nuk e dimë. Na e thuaj ti. Shqiptari befas ia kris gazit, qesh e qesh dhe thotë- Ju sapo bëtë dy Pleniume dhe nuk e dini? Plenium është kur mblidhen ca njerëz, u bien daulleve, kërcejnë dhe hanë rosto një njeri!

Pleniumi i Katërt u kushtohej Ndikimeve të huaja borgjeze dhe revizioniste në Letersi dhe Arte. Enver Hoxha dhe gjithë Byroja Politike marrin pjesë.

Pikërisht në këtë Plenium – njëri ndër momentet më të errët të Historisë së Shqipërisë, Kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë lexon një poezi timen, atë me titullll “Lidhjet e mia me Natyrën”- si ilustrim i një krijimatarie ku “ jeta çvendoset dhe humbasin përshtypjet realiste nga jeta,, Pasi ka lexuar të gjithë poezinë (gjë shumë e rrallë për një Plenium) , Kryetari i Lidhjes vazhdon komentin me një banalitet të paparë fyes (“...Poeti është gjithëçka në natyrë ndersa të tjerëve u jep një racion të caktuar në natyrë...”).

Ky koment, se bashku me poezine e kritikuar, janë botuar në një libër mbi Shqipërinë në Munich të Gjermanisë Perendimore në vitin 1978, në dy faqe.


Si iu duket kjo dhe Kritika si këto kundër shkrimtarëve dhe Krijuesve shqiptarë puritanistëve të sotëm primitiv- atyre puritanistëve moralizues që bëjnë pjesë në atë grupin kanibal të rrahjeve të daulleve dhe të kërcimeve të egra?


4.

Po ngjitesha shkallëve të Bibliotekes Kombëtare , kur u krqyëzova me Nasho Jorgaqin, profesorin tim të dikurshëm të letersisë Shqipe. Më ndal- E di se “Dielli,, i Vatrës ka boatuar diçka rreth teje?- më thotë me një ton disi enigmatik.

‘Dielli’ i Bostonit ishte njëra ndër gazetatat që ruhej në Fondin e literaturës së ndaluar. Nuk lejohej ta merrnje pa patur autorizim. Por Vasilika dhe Entela Domi- kjo e fundit vajza e profesorit tim të gramatikës, të famshmit Mahir Domi,- ishin shpëtimtaret tanë, që ishim të pa-autorizuarit e përjetshëm. Dy vajza të mrekullueshme që rrezikonin vehten e tyre për të na i dhënë për disa orë, fshehurazi dhe pa leje, librat a gazetatat që donim ne!

Ja teksti i gazetës Dielli, January 25,1989:





DY POEZI NGJA RUDOLF MARKU-
Koment nga Hyll Ogreni

Edhe në bahçen pa lule të realizmit socialist-në poezi rrallë e tuk ndodh nonjë mrekulli e vogël.

N'atë grumbull ferrash,gjëmbash,hithrash dhe trëndafilash plastiku (prodhime këto të Uzinës Letrare Enver Gorki) mbijnë tek tuk lule të merme poezije. Në mos u gabofsha, të tilla janë disa poezi nga Rudolf Marku, botuara në revistën Nëntori, 9, 1988. Dy sish po i botojmë këtu.

Tre Veçori, të paktën, i bëjnë këto vjersha të shquhen prej vjershave të realizmit socialist shqiptar:

-tisi i murmë surrealist, me të cilën poeti e vesh atmosferën e brendisë si në vjershën «Kali i Kaligulës» ashtu dhe në «Në kujtim për nënën» – që vetvetiu i veçon ato prej realitetit të realizmit socialist;

-mungesa e bombastiçsmash dhe moralizimesh të «materializmit dialektik»;

-theksimi i ndjenjave personale, individuale dhe shmangia nënshtrimit këtyre ndjenjash ndjenjave «objektive», apo «realitetit objektiv», apo «frymës kolektive» (e tjera dëngla komuniste).

Me fjalë të tjera, në poezitë e Markut ke për të gjetur shënja njerzillëku në ndjenjë dhe singëriteti në shprehje. Gjë e madhe kjo – në një sistem politik – shoqëror ku mbret është terrori dhe mbretëreshë hipokrizia.

Gjë e madhe kjo-në një system ku Mbret është Terrori dhe Mbretëreshë Hipokrizia...

Të them të drejtën, u frikësova! Edhe kur dola nga dyert e Bibiotekës, pashë rreth e rrotull. Fjalja e fundit më ka ndjekur për një kohë shumë të gjatë.

Më vonë kam mësuar se Yll Orgeni ishte një intelektual i mirënjohur në rrethet shqiptare të Amerikës, për kulturën dhe njohjen e madhe të letersiës, dhe si kishte studjuar në Oxford dhe Harvard- ndryshe nga kritizeret puritanist të ditëve tona,- Lizard Kol Askushi and Co- të diplomuar në Universitetin e Urës së Thive dhe të Kosmaçës- siç na thotë Fan Noli profetik para shume e shume vitesh!

Shënim:

Më lejoni të riprodhoj ca botime të miat të hershme : Cikle poetike të viteve të 1971-1972, të botuar në moshen 19 dhe 20 vjeçare; një kritikë e një poezisë time në Pleniumin e Katërt të Komitetit Qëndror, në prani të Enver Hoxhës dhe gjithë udhëheqjes komuniste të Kohës (kritikë që përsëritet pikë për pikë sot në këtë Program televiz Shtetëror të përmendur, nga zhdanovistët modern), dhe një shkrim në gazetën Dielli të shoqërisë Vatra të Bostonit rreth një cikli poetik timin botuar në shtypin shqiptar në vitin 1988.

Lidhjet e mia me natyrën

Lisi është babai im.
Me trupin e drejtë
Me kokëfortësinë për të mos ju përkulur askujt.

Shelgjet janë nënat e mia
Me butësinë e tyre
Brenda skeletit të drunjtë.

Motra ime gjendet tek lulet
Çdo lule kur këputet
Këputë diçka dhe nga zemra ime.

Vëllezërit e mi janë në frymën e erës
Çdo natë kur fryn era
Ndjej se gjaku im është lëvizje.

Ndërsa unë jam tek lumi
Unë jam tek bimët dhe tek gurët.

E SHTUNË, 27 MAJ 1972

Ky njeri lindi mes
fijeve të barit

Këtë njeri, një grua e lindi mes fijeve të gjelbërta të barit,

Në një ditë pranvere.
Mishi i trëndafilte i këtij njeriu mban dhe tani fije bari
Në poret në formë rrënje.

Ky njeri lindi mes fijeve të barit
Në gjelbërimin e përjetëshëm
Le të vinin netët e dimrit,
Le të vinin ditët e vjeshtës!

Ky njeri lindi mes fijeve të gjelbërta të barit
Nën lëkundjen dehëse të erës.
Dimri gjithmonë do të mospërfillet nga ai
Se bari dhe era janë kundër vdekjes.

Në trupin e tij me fije bari
Jeta ka ngjyrë të gjelbër.
Le të vinin netët e dimrit
Le të vinin ditët e vjeshtës!

Ky njeri që lindi jashtë, mes fijeve të barit.
Kur të tjerë lindeshin në krevatet e ngrohtë,
Sigurisht do të pëlqejë të jetë si një fije bari
Sigurisht do të pëlqejë përjetësinë mbi tokë.

Ka një gabim

Ka një gabim në lindjen e trishtimit
Përderisa është e dashura ime.

Ka një gabim në lindjen e ajrit,
E gjithë hapsira mbushet
Vetëm me frymën e së dashurës sime.

Ka një gabim në lindjen e ditëve
Kur trupi i së dashurës
Është me mua në mëngjez.

Ka një gabim në perëndimin e diellit
Përderisa e dashura kurrë nuk vdes.

Unë dhe ai

Atë e ndjek nga pas dallga dehëse e lavdërimeve
ai qesh, por unë them se atij i mirren mendtë
Pastaj ai flë në krevatin e ngrohtë të ëndërrimeve
Kurse mua nga të ftohtët më kërcasin dhëmbët.

E SHTUNË, 27 MAJ 1972

ZERI I RINISË

RUDOLF MARKU

10 poezi

Ky njeri lindi mes
fijeve të barit

Këtë njeri, një grua e lindi mes fijeve të gjelbërta të barit,

Në një ditë pranvere.
Mishi i trëndafilte i këtij njeriu mban dhe tani fije bari
Në poret në formë rrënje.

Ky njeri lindi mes fijeve të barit
Në gjelbërimin e përjetëshëm
Le të vinin netët e dimrit,
Le të vinin ditët e vjeshtës!

Ky njeri lindi mes fijeve të gjelbërta të barit
Nën lëkundjen dehëse të erës.
Dimri gjithmonë do të mospërfillet nga ai
Se bari dhe era janë kundër vdekjes.

Në trupin e tij me fije bari
Jeta ka ngjyrë të gjelbër.
Le të vinin netët e dimrit
Le të vinin ditët e vjeshtës!

Ky njeri që lindi jashtë, mes fijeve të barit.
Kur të tjerë lindeshin në krevatet e ngrohtë,
Sigurisht do të pëlqejë të jetë si një fije bari
Sigurisht do të pëlqejë përjetësinë mbi tokë.

Ka një gabim

Ka një gabim në lindjen e trishtimit
Përderisa është e dashura ime.

Ka një gabim në lindjen e ajrit,
E gjithë hapsira mbushet
Vetëm me frymën e së dashurës sime.

Ka një gabim në lindjen e ditëve
Kur trupi i së dashurës
Është me mua në mëngjez.

Ka një gabim në perëndimin e diellit
Përderisa e dashura kurrë nuk vdes.

Unë dhe ai

Atë e ndjek nga pas dallga dehëse e lavdërimeve
ai qesh, por unë them se atij i mirren mendtë
Pastaj ai flë në krevatin e ngrohtë të ëndërrimeve
Kurse mua nga të ftohtët më kërcasin dhëmbët.

Përsëri do të çfaqet ai mes njerëzve
(Unë do të rihem se atij i mirren mendtë)
Se unë e di mirë ç'do të thotë paqëndrueshmëri e ditëve

Në pemën ku janë të dobëta rrënjët.

Tani, atë e ndjek nga pas dallga dehëse e lavdërimeve,
ai nuk e di dhomën time ku unë shkruaj i krrasur
ai ndoshta tallet me heshtjen time prej rrënje
Dhe më shpjegon mua ç'do të thotë art.

Megjithatë, shkruaj përsëri:
Unë
dhe - ai.

Elsinor - shekulli XX

Aty ku dikur biri i një njeriu të vrarë
Sillej netëve i pagjumë
Vetëm oqeani mbet
Dhe veç oshëtimës gjigande të oqeanit
Birraria -Ofeli-
Kafe -Hamlet-

Aty ku jetonte dikur biri i një njeriu të vrarë
Dhe princi i grabitur pa kurorë.
Vetëm oqeani mbet
Dhe veç oshëtimës gjigande të oqeanit
Birraria -Ofeli-
Kafe -Hamlet-

Aty ku dikur një njeri mbyste oshëtimën gjigande të oqeanit
Me pyetjet rrëngqethëse që i ngjanin dallgëve
Tani oqeani mbet
Dhe veç zhurmimit shurdhues të dallgëve
Reklama në birrarinë -Ofeli-
Dhe në kafe -Hamlet-.

Mos shkelni në heshtjen delikate të vetmisë sime
Atje çdo gjë është thyer - mos shkelni!
Dhe kurr mos pyetni për emrin e asaj që kaloi një ditë

Dhe theu çdo gjë - mos pyetni!
Ajo vetë do ta shqiptojë emrin e saj
Në mbrëmjen kur veltja do t'i duket çuditërisht e huaj.

Nuk ka rëndësi -
Ka për të qeshur, do të qajë,

Me pamjen e pafajësme të gruas.
Mos thoni asnjë fjalë, asgjë mos mallkoni,
Pse theu një ditë çdo gjë dhe la pas veç heshtjen delikate.

Asgjë me rëndësi nuk ka ndodhur.
Unë vetëm shqetësohem
kur ajo thotë e çuditur emrin e saj
si emrin e një njeriu të panjohur.

I vonuari

Ai erdhi shumë vonë. Tashmë
Të gjithë kishin ikur.
Për rreth s'kish ngulur asgjë.

Ata kishin marrë çdo gjë e kishin ikur.
Ai e kuptoi ç'do të thotë i vonuar.

Për rreth s'kish ngulur asgjë.
I vonuar, i vonuar,
Ti duhej të vije më parë,
Të mirrje çdo gjë.

Por tani e kotë për ty britma.
Mbylte dhëmbjen pa mëshirë!
Unë vetë e di ç'do të thotë
Të jesh i vonë dhe i mirë

I vonuar, i vonuar.
Ty të morën çdo gjë,
E të lanë të vetmuar.

Megjithatë
Shoqëroje veten
Me hapat e tua!

N. Gi.

Kaloj përditë pranë heshtjes së tij:
Të tjerët bëjnë zhurmë.
Të tjerët thonë se heshtja kurr s'të sjell lavdi.

Brenda mureve të heshtjes dita dhe nata shkrihen në një

Ai atje qëndron i krrasur mbi tavolinë
Të tjerëve nga vetja u jep çdo gjë.

Në dhomën e tij një ngjyrë të vetme kanë stinët:
Dila zgjatet gjithmonë dhe në kufirin e fundit të natës.

Të tjerët mburren se netëve shohin në ëndërr ditët.

Pastaj në kohën që ne e quajmë njëherë,
Ai do të flasë për të gjithë ata që folën shumë
E megjithatë nuk folën asnjëherë.

Skulptori

Ai u krras mbi bllokun e mermerit pa trajtë.
Ç'mund të shikosh ti në gurët ku s'ka formë?
Ai e di ç'do të thotë art.

Ciflat e gurëve përplasen në hapësirë,
Tani ty të zuri gjumi.
Natën e mirë!

Dalta e tij qëllon bllokun e mermerit pa formë
Aty brenda
Dikush jeton.

E ç'mund të shikosh ti në gurët pa trajtë?
Heshtje ka prej teje.
Vetëm ai e di me fjalën art
Se aty fshihet një kokë e bukur gruaje.

Vetmia

Njerëz të jetonin gjithmonë larg nga njerëzit e
Duke u kyçur në pikëllimin e tyre të gurtë.
Njerëz që përtypnin veten dhe të tjerët me n

Vetmia ju bënë gjithmonë e më shumë të h
Vetmia ju bënë gjithmonë e më tepër të pa
O njerëz, që do t'ju doja dhe në kufirin e m

Kulla të vetmuara dhe njerëz të vetmuar
Në malet që ishin aq të ngjeshur e solide
njeri-
(Malet sikur donin të korigjonin njerëzit).

Njerëzit e lindur
në det

Gjithë ditën ata qëndronin me vështrimin e thellë

Në darkë vinin të rraskapitur në shtëpi
Dhe pyesnin -Ç'do të thotë thellësi?-

Ditët e tjera ata lundronin larg në det.
Në darkë vinin të rraskapitur në shtëpi
Dhe pyesnin -Ç'do të thotë largësi?-

Dihet pastaj se deti vrapon gjithmonë drejt n
Për t'mos qëndruar kurr në vetmi
Në darkë ata pyesnin -Ç'do të thotë dashu

(Një shikim mbi librin “Fëmija i dritës- Edhe një herë për lumin”
të Enton Bidos, botime Jozef, 2020)

MES POEZISË DHE PROZËS... NJË LIBËR I RI

nga Fatmir Minguli

Mes dhjetë librave me poezi e prozë dhe katër librave të përkthyer, Enton Bido ka ndërtuar tashmë portetin e shkrimtarit që ka bërë emër me artin e tij.

Ky portret i ngjan një pirmaideje ku bazamenti i saj është poezia dhe mbi të ngrihen tregimet e novelat, studimet kritike, drama e romani dhe paralele me to janë përkthimet e librave të ndryshëm.

Libri i ri që doli këto ditë nga shtypi është një paralele mes poezive të Entonit dhe poezisë së përkthyer nga poeti modern francez Zhak Prever. Edhe në një libër tjetër, të “Botë të reja” ky autor boton me paralelen poezi dhe përkthime nga autorë të tjerë.

Duke lexuar poezitë e “Fëmijës së dritës” kupton se nuk është vetëm proza poetike me të njejtin titull që e hap siparin e skenave poetike të këtij libri, si proza më e bukur, por janë të gjitha poezitë e tjera. Drita, ky fenomen i natyrës në poezinë e Entonit merr kuptime filozofike duke u veshur me petkun e surealizmit. Drita pëson skanime realizuar në drejtime të ndryshme dhe shfaqet herë si zë, herë si krismë mes territ, herë si far i largët, si dritare qyteti e të tjera vegime.

Vargu i bardhë në shumicën e poezive duket sikur e mund vargun me rimë që ky poet përdor edhe këtë me shumë hijeshi. Në poezitë e ndryshme ndjehet një luftë mes dritës dhe territ, mes optimizmit dhe pezimizmit dhe ai, poeti kap çastin e kuptimit të të jetuarit. Ky konstatim vrehet gjerësisht dhe thellësisht te prozat poetike, që për mendimin tim janë më të bukurat e këtij libri.

Jo më kot në prozën poetike “Loti i motrës dhe varka” ndjehet ringjallja e Arkës së Noes, në “Pushtimi nga retë”, Apoklipsi, në “Dora shpëtimtare”, Mesia, në “Dora ajrore”, zbulesa e në poezinë “Si në ditën e parë të krijimit” nënkuptohen librat e shenjtë. Këtë përsiatje gati të padukëshme bëjnë që libri të marrë hapësira jo të njohura. Atë fjalën për një nivel të lartë mendimi që poeti Enton Bido e ka tashmë të shfaqur në të gjitha krijimet e tij të fundit.

Kjo është e veçanta e parë.

Në poemthin me katër kohë “Netë lakuriqe” shfaqet dhe veçantia e dytë e poezisë së Entonit, ajo e një surealizmi me ngjyra të kozmosit, intersektuar bindshëm me jetën e sotme të rrejtshme (e kush e rruan për libra/ or qorr i ditun?!) ku nuk mungojnë tekstet e këngëve të Aeorsmith apo Megaherc, ku dialekti verior i shqipes ndërhyt me butësi mes reshtave poetikë, etj, etj.

Kur mbaron së lexuari librin “Fëmijë të dritës- Edhe një herë për lumin”, kupton se vetë poezitë e Entonit jetojnë brenda një uniteti, veshur me vargje surreale duke e kthyer absurdin artistik në dhimbjen njerëzore të kohëve që jetojmë.

Botimi i përkthimit të poezisë së Zhak Preverit “Edhe një herë për lumin”, dhe futja si pjesë e dytë e këtij libri është një risi e Enton Bidos, por që hap diskutime të cilat deri tani ndahen në dy interpretime.

I pari, sipas specialistes së letërsisë Teuta Dhima bazohet në faktin e përkthimit tejet original të kësaj vepre me vlera botërore, ku përkthyesi është pothuaj

autor e mbi këtë ide ajo e gjen ngjashmërinë mes pjesës së parë të librit me pjesën e dytë.

Interpretimi i dytë bazohet në disa nuaca të stilit poetik që Enton Bido ka në poezitë e tij, ku tendenca surealiste vjen e forcohet nga poezia në poezi e që vetë Zhak Prever cilësohet si poet surealist. Poezia “Edhe një herë për lumin” është zgjedhur nga Enton Bido jo më kot. Dihet se Zhak Prever njihet kryesisht si poet i dashurisë, ndërsa në këtë poezi ai njihet si poet që skanon skenat e njerëzve të thjeshtë, ata që jetojnë buzë Senës, në kuarteret periferik të Parisit.

Enton Bido ka përpara syve dhe mendjes së tij njerëzit e thjeshtë të Durrësit, dhe jo vetëm ata. Duke i ndërthurur këtë dy të ngjashme unë do bëja dhe paragonizmin mes “Realizmit poetik” të Zhak Preverit dhe “Surealizmit qytetar” të Enton Bidos.

Ndoshta në këtë ngjashmëri duhen shtuar dhe loja me enumeracionet që Zhak preveri i përdor me as mjeshtëri dhe që Enton Bido di t'i sjellë ndryshe në poezitë e tij. Por duhet shtuar dhe ajo ngjashmëri e lakonizmit në vargje, një racionalizëm perfekt në shprehjen e mendimit teorik mbi ekzistencën ton.

Sidoqoftë të dy interpretimet janë të bazuara dhe që i rrisin vlerat librit, prandaj në këtë llogjikë anashkalohen dhe mendimet e shpejta “Pse i ka bashkuar këtë dy pjesë..?”

Ja pjesa e katërt nga poezia brilante “Netë lakuriqe”:

*Po robt, kujt i përkasin?
Territ, dritës,
vedit a tjetrit,
dreqit t'mallkum a Zotit?
.....
.....*

*“s'i kuptova gja jetës- tha vdektari.
Druj se koritem.
Nëse cofi, varromni thellë!
Kush po e din...!
Ma qesin jasht cofinat trupin,
nëse vdes para se me u zgju,
lus Zotin shpirtin me ma ruajtë
e mshirë e ndjesë me pas për mu!”*

*Amen! Amin!
Pastë dritë gjithherë n'amshim!*

I lehtë më qoftë dheu im!

Poezitë e Enton Bidos të shpalosura në librin e tij të ri “Fëmijë të dritës” janë tingëllimë e ardhje së poezisë së re qytetare, poezisë që me figura të surealizmit kritikon situatat sociale, pangjyresinë e tyre e figurat letrare qiellore surealiste kanë zbritur në tokë e i japin shpresë njerëzve në betejat mes pezimizmit dhe optimizmit.

Ja një paralele e bukur për optimizmin që shkruhet në poezinë “Zëri i dritës”:

*Ai, dheu i butë ku mbillemi,
prap na selit, përtërin, ringjall;
bëhemi gjemba, gardenia, apo lisa
të këndëllur nga zëri i parë.*

Është koha që poezia të ringjallë shpresat e njerëzve, klubet e poezive duhet të japin pak shpirt tek njerëzit, poetët e vëretë s'kanë parti. Është koha që grupet e poetëve të thërrasin me qëllimin e sqarimit të së bukurës së vëretë.


Ashtu si poema “Edhe një herë për lumin” e Prever-it edhe poezitë e “Fëmijëve të erës” do hedhin prozhektorët jo mbi brigjet e lumit te senës, sa që e bëri Preveri, por të ndricohen qoftë dhe qirinj sado të vegjël njerëzit e Shqipërisë ku e kaluara e tyre e hershme vinte nga baladat, epet dhe legjendat e mrekullueshme.

Poeti Enton Bido jeton dhe punon në Durrës, por kjo nuk e përjashton atë nga jeta e monopolit dhe mediat monopoliste. Ai është një trashëgimtar i denjë i një fisi dhe si i tillë nga fisi ai merr energji e shpërthen.

Libri “Fëmijë të dritës- edhe një herë për lumin” është një shpërthim i kësaj trashëgimie.

Prurë të mbarë librit dhe suksese autorit!

Durrës
19 nëntor 2020



Shënime për librin “Vargmale nën dhé”, Nurie Emrullai

“PLAKEN ZOGJTË...”

nga Virion Graçi

Jetojmë mes letrarësh e lajmëtarësh letrarë, por deri para ca ditësh, po të pyeste dikush për emrat e dalluar në poezinë bashkëkohore shqipe, emrin Nurie Emrullai nuk do ta kisha shqiptuar; nuk do ta kisha përmendur sepse nuk e njihja poezinë e saj. Libri i saj “Vargmale nën dhé”, (282 f., botimet Onufri, 2020) ka përmasat dhe rëndësinë e një antologjie; antologji e një autori kariere që nga fundi i jetës së gjatë krijuese bën një bilanc të gjërave të çmuara, farkëtuar ndër vite; antologji e një grupi autorësh, të një breznie a nga një mjedis tjetër gjuhësor/krijues. Për habinë tonë fatlume, libri “Vargmale.” ka vetëm një autor/e dhe autor/ja është e re, në fillimet e saj. Dhe lexohet me ëndje, deri në poezinë e mbrame.

Zakonisht, sa e ke kthyer faqen e fundit të çdo libri poetik, është tepër herët të arsyetosh për të: Përse të pëlqeu, çfarë është lëndë e re poetike, çfarë i shton perceptimit tonë të mëparshëm për botën, sendet, marrëdhëniet ndërnjerëzore?! Por libri në fjalë t’i jep vetë disa përgjigje të qarta; ai dallon për shumëçka, dallon për formë shprehjeje e për materie poetike. Duke rrëfyer virtuosisht në disa rregjistra, si në planin lirik, si në poezinë e peizazhit, si në poezinë sentenciale, në planin e mirëfilltë epik, në mistikë dhe në figura të simbolikës natyrore a të jetës qytetëse, poetja nuk bëhet kultivuese e disiplinuar e asnjërës tipologji më vete; përkundrazi, sintetizon me shkathhtësi çdo mjet e liri shprehimore të zhanrit për të mos e ngurtësuar mendimin dhe për ta bërë të dukëshme thellësinë e errët e komplekse të vetvetes. Natyra me pyjet, lëndinat, yjet, hënën, qiellin, retë, shiun, hapësira urbane me rrugët, dyqanet, veshjet, artikujt e konsumit, me bashkësitë shoqërore e familjare, me misteret kaherëshme të ekzistencës si jetë, vdekje, përkohësi, mungesë, mall, zot, harresë, mplakje, krijojnë një trekëndësh Bermundesh ku prozaizmi i përditshmërisë mbytet, përfytyrimet/imazhet poetike shndërrohen në mendim, në ndjesi të fuqishme nëpërmjet bashkëpërjetimit: uni i poetit bëhet dritare e lexuesit, bota autentike e poetit bëhet hapësirë e përbashkët takimi, përjetimi, jeta e rëndomtë kthehet në amëshim poetik.

Poezia “**Kohë e lëngëzuar**” nga e cila e zgjodhëm titullin e këtyre mbresave, paraqet në embrion një parim krijues të Nurie Emrullait: Paralelizmin figurativ. Paralelizmi figurativ diku ndërton antitezën, diku simetrinë e gjendjeve e botëve kufitare, diku përpiqet ta sfumojë botën e madhe për të bërë qëndrore botën intime, e anasjelltas, si në poezinë e sapopërmendur: Plaket dyqanxhiu nëpër artikujt e tij.../... plaken zogjtë që rrinë nëpër lisa.. (f.46) Në këtë shtrirje të madhe hapësinore, plakja e dyqanxhiut që jetën e mat me moshën e fëmijëve që (nuk) blejnë çokollata, shkon krahas me kohën astronomike, me kornosin e universit dhe moshën e pafajshme të gjallesave natyrore, zogjtë në këtë rast. Për nga procedimi, janë ndoshta vargje tipike ku N. Emrullai përvijon fatin njerëzor duke e lënë enkas në sfond njeriun, sekondar, pasojë e rrethanave, përtej sendeve të konsumit dhe natyrës.

Ambiguiteti është tjetër tipar i

ligjërimit poetik të “Vargmale..” Në poezinë “**Dëshmi për breza**”: ...dhe ja ku po fillon numërimi mbrapsht/ Dhe bien tre pika shiu/ Dy/ Një/ Dhe gjethe më i vogël mbetet mbi degë/ Për të shkruar historinë. (f.63) E kemi të pamundur të përcaktohem për çfarë është fjala: Për një idil natyror? Për alegori sociale? Apo ironi me epilogët e proceseve të bujëshme historiko-shoqërore? Ambiguiteti nuk manipulon imagjinatën e perceptuesit, ambiguiteti vjen lehtë për shkak të materialit me të cilën mishërohet figura artistike, bëhet mendim i shumëfishtë, provokon gjendje të reja.

N. Emrullai mprehtësisht kap e ‘qartëson’ një zonë delikate, metafizike, marrëdhëniet nocturne njerëzore, nëmurin e pavetëdijës të dy njerëz të bashkuar në një trup, ‘pronë’ e njëri-tjetrit në dashuri fizike, në marrëdhënie intime, në shprehjet verbale. Në një kryevepër hipokrizie e mefshtësie të marrëdhënieve në çift, poetja dallon orbitat e padukshme midis botëve njerëzore: “**Sa herë që më prekte**” Sa herë që më prekte/ Ndjenja gishtat e tij të preknin një trup tjetër/ Sa herë që më shikonte/ sytë e tij kërkonin shpirt tjetër/ dhe heshtja që rrinte mbi ne/ Më vriste mua, atë dhe një të tretë. (138) Ky rrëfim poetik, në dukje i thjeshtë, i mbart deri në sipërfqen e botës materiale sekretet dramatike të zemrave në lëngim. Poezia tjetër “**Pendesë**” Ëndërrova/ Gjërat më të rëndomta që ka

thellësia e zemrës/ Po kur erdhën një ditë/ Hija e tyre që më e madhe/ E mbuloi tokën time. (f.58) është e së njëjtës lartësi për nga realizimi, për nga finesa e shprehjes. Këtu, si dhe në çdo pjesë të repertorit poetik të “Vargmale...” heroi lirik nuk fajëson e nuk shfajësohet, ai vetëm shfaqet në marrëdhënie që krijojnë tension, kundërshti, palumturi, nganjëherë edhe dëshpërim.

Origjinale në çdo ind të krijimtarisë, N. Emrullai tregohet moderne, e kultivuar, racionalisht e mprehur në trashëgiminë intelektuale të njerëzimit; sakaq, nuk i ndahet bastit të kahmoçëm, përkufizimit e ripërkufizimit të Poetit, Krijuesit, Prijësit: Çfarë e ndan të rëndomtën nga sublimja, vulgaren nga hyjnorja?! Misioni, detyra, qëllimësia e jetës, sikurse shprehet bukur në poezinë “**Korrik**” Edhe xixëllonja e fundit/ Fiku dritën dhe u kthye në insekt të zakonshëm. (f.116)

Në pak sipërfaqe poetikë mund të shkruhet romani i tjetrit, personaliteti i tjetrit, mund të jepet historia e një qyteti; me një duzinë vargjeshe si më poshtë, mund të ndriçohet fizionomia e një shoqërie nëpërmjet njësisë më të vogël të saj, nëpërmjet një njeriu të vetëm e më vete. Poezia “**Ai**” nuk është rastësi në këtë tipologji, por ndër më të arrirat: Pluhuri kishte mbuluar qytetin/ Pluhur, muzg, vapë, qershor./ Njeri./ I futur brenda vetes mbrenda vetes veten./ I mbështjellë në cipa pa fund/ kërkonte dikund fundin./ Çfarë fundi nuk e dinte/ Por kishte një fund/ Që ai mbrenda vetes e priste. (f.37)

Pamjet urbane, pamjet njerëzore dhe pamjet natyrore, N. Emrullai i përbashkon harmonishëm kur rrëfen dashurinë, fëmijërinë e dikurshme, zhgënjimet në miqësi, thyerjet kalimtare shpirtërore, duke maskimalizuar mundësinë shprehëse të çdo fjale e shenje të përdorur: “**Kujtime**” Një cep i fustanit/ Mban ngjitur hijen e faqes tënde/ Përpara se të harroheshim. (f.237)

Poezitë “**Kapërcimi i jetës**” (f.238) dhe “**Njohje**” (f.240), në perceptimin tim prej lexuesi janë të ndërlidhura si fjalë-kyç për të hyrë në anën e padukshme, në origjinën e mishërimeve poetike.

“**Kapërcimi**” Është një vend/ Mes shtëpisë sime dhe shtëpisë së fqinjit/ Që i pret midis rruga e të vdekurve. Poezia e përcakton të tashmen dhe të shkuarën e heroit lirik; ndoshta në këto vargje ka vend profecia profane: heroi jeton në një shoqëri shtetërore ku vdekja është ura lidhëse mes anëtarëve të të njëjtës bashkësi urbane: Duhet të na varsin për të ardhur drejt nesh ose duhet të vrasim për të shkuar te ata? Dilemë specifike, përkthim në poezi i historisë sonë tragjike/dramatike/groteske. Nga ana tjetër, me artin letrar si strehë për unin dhe frymë e shenjtë për vijimësinë njerëzore, heroi lirik është në një tokë të huaj, të panjohur, kujtesa e tij nuk ka si ta ndihmojë; fati e ka paracaktuar mes kryqëzimesh armiqësore, në burg shtëpiak, pa rrugëdalje në jetën e përbashkët. Vetëdija për vendndodhjen e sjell poeten në moshën miturake të pafajësisë, fatalitetit dhe lotëve:

“**Njohje**” Ata më thanë mua shkruaj për gjëra të lumtura/ Unë heshta dhe në vete qava/ Se ato ishin të vetmet gjëra që nuk njihja.

Jo vetëm në shembujt e sjellë këtu, por në tërësi, poetja Nurie Emrullai ka dimensionuar drama individuale në skenën e dramës së përbashkët; gjuha poetike i shpërfaq ndjenjat e imtësishme pa rënë në patetizëm; gjykimi i deshifron iluzionet mashtruese, por poezia nuk bëhet deklarative, moralizuese.

Libri “Vargmale nën dhé” është prurje e jashtëzakonëshme cilësore në poezinë bashkëkohore shqipe; është ansambël poezish ku eksperimenti shndërrohet në risi, prozaizmi i përditësisë – në poezi, liria krijuese shndërrohet në vlerë sipërore estetike, në art të përvetshëm letrar.



Leximi – proces i ndërliqshëm

S'do mend se leximi i një vepre letrare artistike, përpjekja për t'u thelluar në mënyrën si i shpreh shkrimtari dukuritë që i bën objekt trajtimi dhe për të hetuar se çka mund të thotë ajo, sa identifikohet me përvojën tonë si lexues, sa e pasuron atë, sa pajtohet me të dhe sa i kundërvihet asaj, është një proces kompleks dhe vështirë i pranon përkufizimet. Kjo rrjedh nga fakti se leximi i veprës letrare artistike është një fenomen që shprehet në forma të ndryshme të secili person, madje në mënyrë të ndryshme edhe të i njëjti individ me rastin e rileximit të së njëjtës vepër në intervale të ndryshme kohore. Një dukuri e këtillë ngjet për arsye të vetë natyrës dhe qenies së veprës letrare, përkatësisht të mundësisë konotuese dhe komunikuese të gjuhës poetike, e cila, thënë metaforikisht, është shpirti i krijimit letrar artistik. Pikërisht nga vetë leximi (jo nga leximi si akt formal i shqiptimit të shkronjave, fjalive, por një proces që është i lidhur me faktorë paraprakë: përmasa e njohjes së artit letrar e jo vetëm të tij, aftësia për receptivitet dhe për zbërthim, për komunikim etj.) varet se sa do të arrijmë të depërtojmë në botën e veprës letrare, sa do të vëmë një komunikim intensiv ose të pjesshëm me sistemin e ideve që brumosën në të, që nxisin identifikimin ose refuzimin (sidomos atë estetik), me atë që mund të na thotë vepra letrare si sistem unik strukturash, si vlerë artistike. Së këndejmi vepra letrare artistike nuk lexohet lehtë. Sidomos nuk lexohen lehtë ato vepra që shtjellohen nga gjuha poetike e ngritur, që është në gjendje të krijojë një shumësi të pasur të kuptimeve. Për këtë arsye thuhet shpesh se vepra e filan krijuesit nuk kuptohet me leximin e parë, se ajo kërkon një përkushtim më të madh e, natyrisht, edhe një njohje e aftësi për të vënë komunikim me idetë që dalin nga struktura tekstore dhe me gjithë atë shumësi kuptimesh të mundshme që sugjerohet nga nënteksti i saj, përkatësisht nga konteksti poetologjik.

Vepër që do lexuar disa herë

Theksuam veçmas çështjen e leximit të veprës letrare për ta lidhur atë me veprën që e kemi objekt shqyrtimi – Pasqyra e të rrëfyerit të Ramadan Musliut. Në të vërtetë, se sa do ta çmojmë e në ç'mënyrë do ta vlerësojmë këtë vepër të këtij poeti, sa do të depërtojmë në botën poetike të saj dhe së fundit sa do të ndikojë ajo në ne si lexues, kjo varet para se gjithash nga leximi, nga aftësia që të depërtojmë në sistemin e saj kuptimore që del nga struktura e tekstit, që i është nënshtruar një përpunimi deri në imtësi.

Ramadan Musliu edhe në dy përmbledhjet e tjera (Parodia e trupit – 1981 dhe Shqisa e gjashtë 1983), por në mënyrë të veçantë në Pasqyrën e të rrëfyerit, ka përfutur një tekst që asnjëherë nuk ka synuar qartësinë, komunikimin e drejtpërdrejtë, përkatësisht konotimin e kufizuar. Përkundrazi. Ai përfutur një tekst që vetëm nga thellësia e kuptimit të tij zë fill baza e mundësisë së konotimit, e zhvillimit të nyjetimit kuptimor, receptiviteti i të cilit do të varet nga përmasa e njohjes dhe nga aftësia individuale e lexuesit konkret. Vështirësia, më drejt përpjekja për të depërtuar në botën kuptimore – poetike të kësaj vepre lidhet me vetë konceptin bazë të tri përmbledhjeve të këtij krijuesi – me TRUPIN. Në qoftë se lexuesi nuk bën përpjekje të hyjë më thellë në kuptimësitë e mundshme të këtij nocioni, atëherë e ka vështirë të thotë diçka të qëndrueshme e të plotë për poezitë e përmbledhjes në shqyrtim e për vlerat poetike të saj. Ç'është në të vërtetë ky trup te Musliu dhe ç'funksion merr ai në rrafshin poetik dhe në mundësinë e ndikimit estetik?

Morfologjia e qenies – qenësisë ose trupi si materie, si qenie

Në konceptin poetik të Ramadan Musliut Trupi (në fazën fillestare) del vetëm një materie që është potencial i mundshëm për ekzistim, në kuptimin e funksionimit dhe të gjallimit. Si materie fillestare ai është vetëm pyll i errët, i cili as që ka ndonjë vlerë, as funksion e as mund të përdoret për ndonjë gjë të dobishme. Trupi shndërrohet në qenie, në qenësi të ekzistimit dhe të funksionimit vetëm kur, thënë metaforikisht, shpirtërohet nga shqisat. Atë e ngjallin shqisat; ato i japin materies përmasën e qenies dhe me këtë trupi fiton mundësinë e ndjeshmërisë, të njohjes e të veprimit, por edhe të pësimit dhe të shkatërrimit. Me futjen e shqisave trupi bëhet qenie komplekse që provon vetekzistimit, që nënkupton vlerën, verifikimin e vetëqenies; në këtë mënyrë trupi fiton një përmasë të jashtëzakonshme të shprehimësisë së veçorive

“PASQYRA E TË RRËFYERIT” E RAMADAN MUSLIUT – DËSHMI E MIRËFILLTË E POETIT TË MADH


nga ANTON NIKË BERISHA

të shumta dhe esencialisht nënkupton trungun, qenësinë. Musliu me qëllim nuk e ka pluralizuar trupin për ta parë në dritën e shumësisë së njerëzve, të kolektivitetit. Ai e ka marrë trupin si një qenie më vete për ta trajtuar e për ta shprehur atë në mënyrë sa më të thellë e më të plotë. Në fundin e mbramë koncepti poetik i trupit te ky krijues nënkupton njeriun, individin dhe me këtë shprehet identifikimi i ndërsjellë, përligjur nga të dhënat rreth ndjeshmërisë, funksionimit që fiton trupi me shqisa. Një

koncept i këtillë i trajtimit ka bazën e vet në Bibël dhe në veprën e Musliut merr nuancë të theksuar poetike e estetike.

Veprimi si dëshmi e vetekzistimit

Trupi, trungu ose qenia vetëm si materie, në konceptin poetik të Musliut, del si diçka e pa vlerë ose, siç thotë poeti “Gjë e hedhur send i vjetër”. Siç thash, shqisat e bëjnë atë



qenie aktive. Qenësisht me fitimin e kodit shqisor trupi ose qenia fiton tipare të shumta e cilësore. Në procesin kompleks të funksionimit shqisat e zgjerojnë mundësinë dhe forcën e tyre të veprimit në trup dhe shndërrimin e tij në një përbërje të re; ato e vetëdijësojnë trupin dhe e bëjnë një “libër të hapur”. Kështu ai fiton tipare në dy rrafshë: në vetëdijesimin e ekzistencës, të funksionimit të një sistemi të ngritur të shqisave e të dëshimit të tyre unik brenda trupit, por edhe të trupit në krahasim me dukuritë që ndodhin jashtë tij, po të cilat ndikojnë në të, përkatësisht bëhen pjesë e tij, qoftë si aktive, qoftë kur ruhen në nëndije. Dhe sa më shumë që zhvillohen shqisat, aq më tepër trupi fisnikërohet dhe bëhet i vlershëm. Ç’është e vërteta, në këtë raport – ndaj vetvetes (vetëqenies) dhe ndaj qenieve e dukurive të tjera – trupi me shqisat shndërrohet në qenie të ndërlikuar, në të cilën shprehen cilësi të ndryshme, dukuri që do të varen nga trupi dhe nga ajo që ngjet jashtë tij, në jetë. Së këndejmi trupi ka nevojë për përsosje, zhvillim sa më të plotë e të gjithanshëm.

*...duhet punuar pa ia ndarë
nëpër vetvete
se trupi heq keq
për Zot
e për shpirt të dëlirë.*

Shqiptim i dukurive qenësore

Trupi me shqisa në konceptin poetik të R. Musliut nënkupton, siç thamë, trungun, qenien e njeriut, qenësinë e jetësimit dhe të veprimit. Duke u nisur dhe duke e zhvilluar një koncept të këtillë poetik rrëfimi për trupin do të thotë rrëfimi për njeriun, për botën dhe për problemet e tij. Ky rrëfim te Musliu cilësohet me disa tipare dhe në qenësi përshkohet nga një ndjenjë e thellë e tragjikes dhe e dhembjes. Gjithë kjo (siç ngjet edhe në poezinë me titull “Java e krijimit”) fillon me harrimin, me kobin, me dhembjen, me mëkatin, me zjarrin me acarin (që nënkuptojnë pësimin), me lotin etj. Rrëfimi i shtjelluar mbi bazën e konceptimit poetik që u përmend shtrihet në dy rrafshë: a) në atë personal, që lidhet me botën e poetit, me preokupimet e tij, me shqetësimet, me pësimet, me gjithë atë që përjeton si një trup, si një qenie që është e varur shumë nga rrethi, nga e kaluara, nga e tanishmja dhe b) në rrafshin kolektiv, në rrafshin nacional dhe ndërnacional. Përimtimi i këtyre dy rrafshëve dhe raporti midis tyre – ajo lidhshmëri dialektike, ku del në shesh gjithë madhështia dhe tragjika e individit – përbën qenësinë e gjithë poezisë së këtij krijuesi. Rrëfimi poetik shtjellohet mbi bazën e kuptimësisë që del nga një rrafsh thellësor dhe shprehet përmes një gjuhe poetike me cilësi dhe forcë shprehëse. Shqetësimi i poetit – i shqiptuar përmes kuptimësisë së trupit si nocion bazë – zë fill me dimensionin individual. Poeti e ndien gjithë tragjiken e fatit prej njeriu, i ndien dhe i përjeton shqetësimet e shumta, që kanë të bëjnë me të e me njerëzit e tij, me të kaluarën e me të tashmen, me gjithë atë që e cilëson kombëtare, që i përket individit. Poeti si qenie, si individ i përjeton këto në mënyra të ndryshme dhe i shpreh përmes një rrëfimi kuptimisht të pasur dhe artistikisht të ngritur. Shqetësimet e tij janë të shumta, të ndryshme, por edhe të përhershme: “Zjarr kohe në shpirt ruaj” dhe “Zjarrin tim që s’shuhet dot”. Ai vëren kotësinë e veprimit, pamundësinë e ballafaqimit dhe të ngadhënjimit të dëshirave dhe të synimeve. Ideali i tij është jeta ku s’ka vaj e s’ka lot, por ajo është vetëm një përfytyrim, një rrjetë e merimangës së gjumit të tij.

*Merimangë e gjumit tim
thur rrjetën për jetë e mot
rrjetë dëshirash për amshim...*

Shqiptimi i një tragjike të këtillë sa shkon e merr përmasë më të madhe, shprehet në forma të ndryshme dhe bëhet dominues. Jeta bën “Zigzake deri në çmendje”. Kjo është verifikuar në rrjedhën e zhvillimit historik. Malli varfanjak i poetit e shpie atë buzë vdekjes, etja nuk i shuhet, ndërsa kënga i bëhet e kobshme.

*I përgjumur në lojë
hyj i lirë e dal rob
zemra ime a të zgjoj
nga gjumi i këngës kob
ose
Perde loti në faqen time
griset varet nën thua
dhembjeje e shpresimi.*

Një gjendje e këtillë herë-herë merr përmasë shqetësuese. Në shqiptimin e botës vetjake mbretëron e shprehet terri, frika, pasiguria. Terri zë nga irida,

ndërsa harta e zezë varet në “qytet ndjenje plot zjarr e hi”. Pikërisht para hirit, thotë poeti, “shpirtit tim i këndoju ratë”. Tëhuajësimi, vetmia, frika sa shkojnë e shprehen me gjithë ashpërsinë e tyre të mundshme; bëhen element kryesor i gjallimit të poetit, i botës së hirit.

Koha nën zero në shpirt ka ardhur

Ai kërkon shpëtim prej territ që është futur në qenie, që si shqetësim shprehet në forma të ndryshme, sidomos përmes përsiatjeve për fatin tragjik të njeriut (poeti kujton Hiroshimën), përkatësisht të fatit të tij.

*Brenda dhomës pa asnjë kandil
për qenien time kërkoj azil.*

Mirëpo, këtë shqetësim, përkatësisht shqiptimin e fatit të këtillë të individit poeti do ta përgjithësojë dhe do ta lidhë me fatin e qenies njerëzore, në përgjithësi.

*Dielli i jetës mbi trup varrë
jetës dhe vdekjes i fal Saharë*

ose shembulli që është një antitezë e Diellit dhe Saharës:

*Akulli shkrin
në frigorifer
akulli në zemër
ngrin gjithë ditën*

Ç’është kjo që e ka pezmatuar poetin përtej masës, ia ka lëkundur të tanishmen dhe të ardhshmen, shpresën. Mos ndoshta shpërdorimi apo më drejt përdorimi për të keq i vetëdijes së njeriut që me veprimin e tij t’i kundërvihet atij vetë?! Ç’ndodh kështu me njeriun dhe ku janë arsyet e një tragjike të këtillë? Poeti nuk e shpalos këtë gjë, por nëpërmjet të rrëfimit poetik prej poezie në poezi na jep elemente të sjellimit përfundimit vetjak. Ja dy vargje që mund të shërbejnë si nismë për kuptimin e problemit:

*Dikush këtë tinëzisht shikon
dhe fyturën e botës me gjak vizaton.
Kuptimësia e mërgimit të trupit*

Trupi i mbëltuar me shqisa bëhet shumëfunksional. Vetëdijesimi i tij nënkupton përparësinë, por njëherit dhe mundësinë e përjetimit të shqetësimit e të tragjikes. Me këtë trupi shpreh morfologjinë e re; shqisat marrin funksionin kryesor dhe e drejtojnë atë. Pushteti i tyre bëhet i pakufishëm. Kjo ngjet me gjithë atë që ndodh brenda trupit, por edhe jashtë tij si rrjedhojë e aftësisë së shqisave, e reagimeve dhe e veprimit të tyre. Një ndërlidhje e këtillë e morfologjisë së brendshme të trupit me shqisat dhe e shqisave me ambientin dhe dukuritë janë, siç do të thotë poeti, pasqyra të dyfishta, nga brenda dhe nga jashtë.

*Trupi është i përsosur
në vetvete
me pesë pasqyra të dyfishta
nga jashtë
dhe një përmbrënda*

Nëpërmjet vetëdijes dhe aktivizimit të nëndijes, si burim i potencialeve të qenies, trupit, vihet një kontakt më i gjithanshëm dhe më intensiv me dukuritë, me të tashmen dhe me të kaluarën. Kjo ngjet nëpërmjet të parabolave të ndryshme, me të cilat vihet lidhja me fenomenet e shumta, me kuptimet, me atë që ka ndodhur, që ndodh ose që mund të ndodhë. Një mundësi e tillë e

funksionimit dhe e veprimit të shqisave të trupit krijon mundësinë e komunikimit të nyjshëm, e proceseve shumë komplekse që nuk mund të ndodhin askund jashtë trupit dhe jashtë një përbërje të tillë anatomike. Kjo përbërje është e aftë të na kthejë thellësisht në histori, të na përkujtojë dukuri e çaste kryesore nga historia e njeriut (ruajtur përmes përvojës dhe gjërave të ndryshme të gjetura, përmes shkrimit etj.), nga historia nacionale, me të cilën individit është fort i lidhur dhe me këto të nxisë një komunikim shumëplanesh. Tipari që në procesin e ekzistimit dhe të veprimit shqisat të “dalin jashtë trupit”, të “mërgojnë” në kohë dhe hapësirë – përmes përsiatjeve, kujtimeve, mallit etj. – shpreh një nga esencat e trupit.

*Koha më ngriu
para pasqyrës sime të të rrëfyerit
duke kërkuar shëlbim
nga trupi që po mërgon
jashtë vetvetes*

ose

*E prek trupin
a e kam me vete
apo thneglat po ma bartin
nën dhe në mërgim.*

Jo vetëm “dhembja” bëhet qiri dhe me shkrihet “nëpër palcë”, por nëpër palcë i gjallon malli, personalitetet, ngadhënjimet e sakrificat, e kaluara. “Mërgimi” në to është mërgim tjetër nga kuptimi klasik i kësaj fjale. Këtu mërgon – të themi me konceptin biblik – shpirti. Ai bën lidhjet me dukuritë, me çështjet nga më të ndryshmet. Në këtë mënyrë ato bëhen pjesë e qenies, e ekzistencës.

*Mes emrave: historia
mes foljeve: jeta
nëpër këngë: vepra
Tha: kjo është e tëra
gramatikë e trupit.*

Ky komunikim me një spektër kaq të madh dukurish ndikon që ato të ekzistojnë dhe të bashkekzistojnë te njeriu. Mungesa e një komunikimi të këtillë do të shkaktonte që qenia të shndërrohet në torzo, në diçka të pjesshme e të pa funksion, sikur do të ishte, fjala vjen, trupi pa shqisa.

Kjo që thamë është një mundësi e leximit të veprës së Ramadan Musliut “Pasqyra e të rrëfyerit”, një përpjekje për ta interpretuar konceptin bazë të poezisë së këtij krijuesi që shprehet përmes nocionit të Trupit. Ky koncept poetik, shtjelluar me shkathtësi, merr funksion të shumëfishtë në secilën poezi e cikël dhe në gjithë përmbledhjen si tërësi. Ai është konceptuar me kujdes e shkathtësi: fillon me elementet e krijimit të gjithësisë, vazhdon me shenjat e trupit, me shenjat e njohjes, me memorien e gjallë, me mërgimin e trupit dhe përmbillet me pasqyrën e të rrëfyerit. Gjithë kjo shpreh rrëfimin poetik të morfologjisë së qenies, zhvillimit dhe të qenësisë së saj, të shqiptuar nëpërmjet një mesazhi të pasur dhe artistikisht unik, që është cilësi e veprave letrare të mëdha, dëshmi jo vetëm e ngritjes së nivelit poetik të këtij krijuesi, por edhe e poezisë sonë bashkëkohore.



Terri është qefini im

poezi nga

NUHI SADIKU

CURRICULUM VITAE

njëzetënjë korrik njëmijëenëntëqindëntëdhjetëetë

Sytë hapur i kam në ditën e tretë të shtetrrrethimit
Buzëve të mia lëpiva shijen e vajit të parë
Mbi tradhëtinë e zombi – perëndive

Detin e qetësisë pluskuan pika shiu të gjakta
Mallkuar qofsh më thanë ti shpirtshejtan i vogël
Se paskam qarë kur të gjithëve ju ngurtësuan lotët

Dhe kur fillova të thërras zotin tim në emër
Mësova t’ia shtrydh cicat e mavijosura jetës
Për t’ia nxjerrë tamblin e kristaltë të vetëfuqisë

Dikur hapa gjithë truallin e zemrës sime
Aty farë të kalbur më hudhën nga secili horizont
Veç pse kam sharë krejt të pushtetshmit e botës

Sot humbas kokën nëpër libra të ndryshëm poezish
Dhe vazhdoj të shahem prej servilëve të perëndive
Se paskam lexuar librat e ndaluar unë shpirtshejtani
i dikurshëm

EKSTAZË

krejt qenien time e mbylla si asket
e sytë e mi pikojnë gjak
për ta kafshuar truallin e mollëve tua
bota le të marrë në thua

derdha një rigë zhgënjimi
siç derdh ti kafenë e hidhët përgjysmë
pështyva si qen i terbuar gjak në tokë
ekstaza rrjedh në mua

piva një gotë marrëzi gotën theva
me copëzat e ndara i preva venat
për të të larë në gjak pasi të të bëj të thuash
të lahem s’dua

kur mbi ty rigon kënaqësi e bardhë
qefin i larë me ujë të shenjtë
të mbështjellë e të dërgon në Eden
të falura janë mëkatet tua

JEHU I VAJTIMIT

Hapëroj rreth e përqark
I ndjekur pas nga hija e një demoni
Në botën që para duarsh po më vdes
Me sëmundjen e artikulimit të së vërtetës
Mbi sfondin etik të shëmtisë

Buzëmbërëmjat vijnë prej xhamit të lagur
Nga ajri që doli prej frymëmarrjeve të paralizuara
Kur mërzia preku në gabzherr
Muzgu mbështolli kokat
Shpirtat u prangosën
Dhe bënë lutjen e fundit

Herezia është pelerinë tmerri

Kur je në morgun e shpirtave të këputur
Dhe shpresave të mbytura

Kush e kemi radhën
Të shpëlahemi në Ujin e Zi
Që rrjedh nga një WC publike e ndyrë
Ku politikanët derdhin darkat e yndyrshme
Në një trajtë të shenjtë metafizike

Kur humbi kuptimi i gjithçkasë
Flamuri i njerëzisë pa ndjenja ra
Dhe u skuq nga një llum menstruacionesh

Tani gjithçka që kam
Është ky jeh i vajtimit
Dhe një këngë rock nga Pink Floyd

.

NJERIU QË FLINTE ME HIJEN E VET

zgjohej në zgrip të zakonit
dhe thërriste si i marrë
një hije të trilluar ekzistence

gjumë i gjakosur gjuante
përflakjen në dy sy të ndezur
me aktin e pamoralshëm të shëmtisë

idetë e tij të inatosura
mbështilleshin me emocion
frike dhe tëhuajsimi
male mendimesh mediokre
ka kohë që i kishin shpallë luftë
këtij asketi të çuditshëm me trajtë njeriu
ikte e ikte e ikte
nga frika se liria e tij
është asgjësuar dhe binte në gjumë
zgjimi është i rëndë

prandaj ai pas seksit
gjithmonë flinte me hijen e vet
për ta lënë të paktën një trashëgimtar
në fronin e tij prej asgjëje

nëse një ditë nuk do të zgjohej më

OMBRELLA QË MË MBRON NGA FATI IM

Ombrella që më mbron nga fati im
s’ka qenë këtu për shumë
kohë

Ombrella që më mbron nga fati im
nuk ka më shumë se dy pëllëmbë
hapësirë

Fati im që mbrohet nga ombrella
nuk gjendet në asnjë vend tjetër
pos në kohëhapësirë
i lidhur me nyjën e dëshpërimit

Fati im që mbrohet nga ombrella
nuk më sulmon me asgjë tjetër
përveç trishtimit

Ombrella që më mbron nga fati im
Fati im që mbrohet nga ombrella
janë krijesa që kutërbojnë erë

Fati im i trishtë dhe ombrella e vogël
janë trajtë e venitjes
së një luleje në fillimverë.

RITUAL

dhe çdo mbrëmje në mua rilind një dashuri
e engjëllt dhe e padjallëzuar si kurnjëherë më parë
sikur t’i jenë djegur të gjitha caqet e zemrës

dhe çdo mbrëmje unë mbes në vetmi
tentoj ta ruaj një grusht dashuri sa për farë
veten time ta kufizoj veç brenda ndjenjës

dhe çdo mbrëmje unë digjem kam zjarrmi
në heshtje filloj i numëroj lotët e mi të tharë
nuk dua t’i rrëfehëm dritës së hënës

pastaj çdo mëngjes dashuria ime bëhet hi
veç kujtimet e saj mbillen në një arë
mbinë legjendë e dashurisë sikur legjendë e zanës



RRUGA E MACEVE

Në një rrugicë të qytetit të harruar
Çdo gjë nis e kryhet sipas ritmit të vet
Në mëngjes përqafohet nga një tis mjegulle
Në terr kotet si një tokë e pabanuar
Kur trupi i akullt i mbrëmjes i prek ashtin
Aty gjithçka zhduket rrëmishëm
Përveç një mbretërie macesh
Të tmerruara nga habia

Në rrugicën plot zhurmë e mjaullima
Kur derdhet shiu nga gryka
Dhe nga pallatet bojëkuqe
Rëndon aroma e bukës në furrë
Macet struken jo për shumë kohë
Për t’u mos lagur nga uji i mëkatit njerëzor
Një panoramë e hirtë betoni
Shtrirë mbi rrugicën e maceve
Përmbys muajt një nga një

Në rrugicën e ngushtë të qytetit të harruar
Çdo gjë ka ritmin e vet
Përveç një mbretërie macesh
Që sundon sipas zakonit të vet

SHËNIME PERSONALE

Ky dimër sikur të jetë i dëbuar nga stinët
në tridhjetë e tri copë mbart pikëllimin e imët

Mbi peizazhin e bardhë e zënë gafil jeta
çirret e lëngon nga frymëzëniet e helmëta

Psherëtimash të pështira damkoset ceremonia
e vrasjes së trishtueshme të dëshirave të mia

Krejt çka më shoqëron: e kobshme kjo jehonë
vajton për të ardhmen e hirit tonë

Është revoltuar liria: s’është më lule që mbinë
po kalorës apokalipsi që shpatën fërfërin

Në perin e fytit. Që është i hollë e s’këputet
ndonëse angështia e tërheq nga të gjitha skutat

Asgjë nuk lëviz e gjithçka pas na ndjekë
shtrati i kujtimeve prapa na është rrekë

Kush ka pakëz guxim kush ka pakëz nur
Ankthit të lirisë t’ia thyejë këtë mur

Një kreshnik mitik që tamël zanash piu
Se i fortë është guri gati sa njeriu

TERRI ËSHTË QEFINI IM

Nata lëshon perden e zezë të rëndesës mbi mua
Mbyll qepallat e vuajtjes së mbetur peng
Thërret në një rizgjim të ri

Sa të egra janë kujisjet e kujtesës
Në këtë natë të ftohtë nëntori
Simbol i gërryerjes së brishtësisë

Nuk e di pse s’munda asnjëherë t’i flas natës
Turpërohesha nga gjumi i shekujve
Nuancat e kafshëtrajtimit i gjej brenda vetes

Si nuk munda asnjëherë t’ia them këngës
E si të këndohet kur frymën zënë na e ka
Jastëku i perëndive

Nata rëndon mbi mua si trup planetar
Shtyn numërimin së prapthi
Deri në rizgjimin e ri

Varrosmëni
të mbështjellur me terrin tim

Brenda teje këndojnë gjithë zogjtë e botës
poezi nga
ILIR BELLIU

Ilir Belliu (1971-2001) është nga poetët më të dalluar të viteve nëntëdhjetë, është i tillë në krejt letërsinë shqipe. U shua herët si jetë njerëzore, por la pas disa libra poetikë. Krahës nderimit të radhës për poetin I. Belliu, prej të cilit janë zgjedhur poezitë e mëposhtëme, vlejnë të përgëzohen miqtë e tij të “Bota e re” Korçë, Petraq Kita e Lulëzim Agolli të cilët mundësuan botimin e librit të parë, “Vetmi me njerëz”, 1993; poeti Skënder Rusi si redaktor dhe mbështetës financues i librit “Një lumë i vogël rrjedh në kafkën time”, 2002; “Klubi Letrar Aleph” me G. Çoçoli, M. Marku, A. Tufa, R. Zekthi, V. Graçi i cili, numërin 11 të tij, Vjeshtë 2001, ia kushtoi jetës dhe veprës poetike të Ilir Belliut, poezi të zgjedhura të tij dhe shkrime përcjellëse të kolegëve.



GJYMTYRË

S’më shihni?!
Hedhurina ëndërrore
Mbledh padukshëm...
Doemos, për t’iu shmangur
Këtij shkatërrimtari
Që gri ekziston...
Tek e mbramja
Gjithkush bie pre
E gjymtyrëve që flasin.

MË LINI VETËM

Më lini vetëm!
Kam nevojë të qaj!
Në shkëmbim të vetvetes.
Shi...
Shi që puth me eps
Buzët e Tokësores
Shi...
Shi që trishtëm kotet
Si qen i qelqtë.
Më lini vetëm!
Për ju të festojmë,
Të këndojmë të varur
Në trekëndëshin e diellit.

JEMI NJERËZ.

E shoh...
Fushën femërore
Mbjell bujku I puthjes.
Jemi njerëz...
Fatmirësisht kafkat
Nën hënë na kullosin
Barinj të e nëndheshëm.

BRENDA TEJE KËNDOJNË
GJITHË ZOGJTË E BOTËS.

Fisnike je
Si një gjethe e kuqe dielli
Brenda teje gjithë zogjtë e botës këndojnë
Dhe askujt s’i shkon ndërmend
Se aty jepen koncerte.
Ndryshme, me orë të tëra
Do të mbanin vesh
Dhe agimi i prirur
Për të qeshur me lotë
Dhe princi i shndritshëm i shiut
Që duket shkoqur që qan
Dhe mëzi i pashtruar
Prej gjithkujt i harruar
Që me siguri kish për t’u madhëruar.

LOJË

Harrova të vish.
Po ç’them?...

Gishtat e mi
Kanë kohë që lozin
Me bishtalecat e tua
Si ca pinguinë të vegjël.

BABAI

Kot fle pa trup
Sikur jam në rrugë.
Troje cicërimash
Vershët e mia gri
Liridashës si ky qiell
Që vdes së jetuari
Në çastin e orgazmës!
Domethënë babai
Më ndjek me zë
Si një lepur që e ka krizë
Një dorë të ngordhur.

NJË PËR ÇDO LLOJ

nga Julian Barnes

Gjithmonë kam pasur një teori për Rumaninë. Nejse, jo gjithmonë një teori të mirëfilltë; ma ha mendja se është më tepër një vëzhgim. A e keni vënë re se, në shumë fusha, Rumania ka arritur të nxjerrë një - por vetëm një - artist të dëgjuar? Është njësoj si të thuash se rumunët kanë forcë për të krijuar, në çdo gjë, vetëm një ekzemplar - si ato bimët që e kanalizojnë të gjithë energjinë në një lule të vetme. Pra: një skulptor i madh - Brancusi; një dramaturg - Ionesco; një kompozitor - Enescu; një karikaturist - Steinberg. Madje, dhe një mit popullor i famshëm - Dracula.

Dikur, gjatë një takimi letrar, ia përmenda këtë teori një shkrimtari rumun në mërgim. Marian Tiriace-i ishte një burrë i verdhemë, i bëshëm e luftarak, por unë, duke iu referuar çështjes së 'disidentëve', gjithçka me të e kisha filluar mbrapsht. Përdorimi i fjalës 'disident' me të mërguar të Evropës lindore është gjithmonë i papërshtatshëm, gjë që duhej ta kisha vënë re më parë. Disa prej tyre pozicionohen politikisht në linjën 'Disidente është qeveria'; të tjerë, në linjën personale dhe praktike 'Unë nuk jam disident; jam shkrimtar.' Tiriace-in e kisha pyetur ngeshëm nëse në Rumani kishte disidentë. Me një energji të tepruar ai i dha një rrotullim të plotë verës së bardhë të ofruar nga një botues që kishte mbetur në fundin e gotës, dhe pa derdhur as një pikë të vetme u përgjigj:

'Në Rumani nuk ka disidentë. Aty ka vetëm një numër të vogël njerëzish të cilët nuk janë të disponueshëm për shtypin e huaj. Sido që të jetë, ata jetojnë disi larg nga Bukureshti. Rrugët, deri në kufirin me Hungarinë, janë të këqija; dhe gazetarët tuaj nuk është se janë shumë kureshtarë.'

Ai foli me ironi, por edhe me një lloj krenarie të çuditshme - a thua se unë nuk e kisha të drejtën për të shprehur mendimin tim - apo për të bërë një pyetje - në lidhje me atdheun e tij. Pa dashur të hiqja dorë, por edhe pa dashur ta ngacmoja më tej, i parashtrova Teorinë time rumune; këtë e bëra me urtësinë dhe hezitimin e duhur anglez tek u shtira si i paditur, ndërsa ai zgjati dorën drejt një kokrrë tjetër ulliri të mbushur duke më buzëqeshur me një zemërmirësi të mjaftueshme.

'Ju harroni poezinë,' tha ai. 'Eminescu.' Ishte një emër që e kisha hasur vagëllimthi, ndaj pohova me kokë në shenjë të një aprovimi të mjerë. 'Harroni tenisën - Nastase.' Një tjetër pohim vijoi; mos vallë po më vinte në lojë? 'Dhe udhëheqjen e partisë - Ceausescu.' Tani po, ai po më vinte në lojë.

'Po romancierët?' këmbëngula unë. 'A ka ndonjë të tillë që duhet ta kem dëgjuar?'

'Jo,' u përgjigj ai me një lëvizje mohuese dhe të trishtueshme të kokës. 'Nuk ka asnjë. Ne nuk kemi romancierë.'

Kur më ftuan për të marrë pjesë në konferencën e shkrimtarëve të rinj në Bukuresht, kishte pothuajse një vit që e kisha harruar bisedën me të. Evenimenti ishte sa i këndshëm, aq edhe i pakuptimtë - dëgjova me dhjetëra ligjërata rravguese, por qëllimmira, për detyrën e shkrimtarit ndaj njerëzimit, si edhe për fuqinë e fjalës së shkruar në formimin e botës shpirtërore të njerëzve - sidoqoftë, të paktën m'u dha mundësia për të vizituar një vend që në rast të kundërt nuk do ta kisha parë. Na shtruan bankete me liker kumbulle, më pas organizuan një ekskursion në deltën e Danubit, ku sytë i sforcuam në kërkim të pelikanëve që ndërmerrnin fluturime të largëta, por edhe mbrëmje në të cilat zyrtarët lokalë bënë pyetje serioze për profesionin e

shkrimtarit - pyetje që të bënë pak si me turp, a thua se profesionin tënd duhej ta merrje më seriozisht sesa e kishe marrë deri në ato çaste.

Mëngjesi i fundit i udhëtimit ishte planifikuar si kohë e lirë, për këtë arsye dola për një shëtitje në qytet bashkë me një shkrimtar italian, i cili eksperimentonte me poezinë. Pamë nga afër kisha të vogla e të errëta, por të qeta, me përjashtim të kërcëllitjes së qirinjeve prej dyllë blete dhe zvarritjes së këmbëve të të moshuarve. Vizituam Muzeun e Arteve të Republikës Socialiste të Rumanisë ku pamë portretin e një gruaje nga qyteti me lëkurë ngjyrë ulliri dhe një shami blu mbi kokë, vepër kjo e Van Eyck-ut; emri në pjesën metalike ishte fshirë nga gishtërinjtë adhures, a thua se kjo, piktura më e bukur e galerisë ishte shndërruar në një ikonë që duhej prekur për të sjellë mbarësi, dhe jo më pak se prekja e këmbëve në skulpturën e Shën Mërisë. Në fund, bëmë një shëtitje përgjatë Calea Victoriei dhe pastaj u futëm në disa dyqane. Te qoshja e Palatul Republicii, përballë godinës së Komitetit Qendror, gjetëm një librari. Njëra prej vitrinave i ishte përkushtuar një vepre të vetme, një romani të shkruar nga dikush i quajtur Nicolai Petrescu; për një farë kohe, zgurdulluam sytë tek piramida e kopjeve të librit, tek pyesnim veten nëse autorin e kishim takuar në ditët paraardhëse. Një fotografi e vogël në qoshen e kësaj reklame - që tregonte një burrë të bëshëm, mjekërbardhë dhe me

një palë syze xhami pa skelet - vërtetoi se ne nuk e kishim takuar. Meqenëse libraria dukej se ishte një nga më të mëdhatë në vend, dhe vetë Petrescu, nga sa mund të merret me mend, një nga shkrimtarët më të rëndësishëm të tij, na u duk pak si e çuditshme që ai nuk ishte dërguar bashkë me të tjerët për ta shijuar likerën e kumbullës që ishte dhënë falas.

Miku im dhe unë ia hodhëm sytë për disa çaste seksionit të gjuhëve perëndimore të librisë - por nëse ju jeni i huaj dhe planifikoni të shisni në Bukuresht, do të ishte më mirë që, për së gjalli, me këtë mos të merreshit - por të shkonit diku gjetkë. Më pas, udhëtuam me makinë në aeroportin Otopeni, nga ku u kthyem me avion në atdhe.

Kaluan disa muaj pa u takuar me Marian Tiriace-in, por kur e takova, i ofrova që t'i jepja përshtypjet e mia për vendin të cilin ai nuk e kishte parë gjatë mërgimit të tij tridhjetëvjeçar. Ishte e qartë se ideja atij nuk i shkaktoi asnjë lloj turbullimi, sqaroi pa as më të voglin dyshim se aty nuk do të kthehej kurrë, dhe gjithashtu theksoi se nuk donte t'ia dinte se ç'kishte ndodhur me atë vend. Gjatë viteve të para të mërgimit ai kishte qenë i pikëlluar e nostalgjik, por edhe kishte mbajtur një korrespondencë qaramane me miqtë e tij; kjo nuk i kishte bërë aspak mirë, gjërat i kishte përkeqësuar, ndaj dhe ai, tashmë, i kishte këputur të gjitha kontaktet.

'Sidoqoftë,' vazhdova unë, 'Ti nuk ma ke thënë të vërtetën. Romancierë në Rumani ka.'

'Oh, ndoshta. Doni të thoni, Rebreanu. Ndoshta dhe Sadoveanu. Unë ndruhem se sot ata janë thjesht material për teza. Ata nuk janë Brancusi apo Nastase të cilët ju po i kërkonit.

'Jo, nuk thashë atë.' Dhe zor se mund të ishte kështu, sepse emrat e tyre ishin të panjohur për mua. 'Thjesht, doja të thoja se akoma kanë mbetur disa shkrimtarë. Ata pak që takuam.' Përmenda tre a katër emra. Ai mohoi me kokë.

'Nuk duhet ta harroni se unë nuk tregoj shumë interes për gjëra të tilla tani.'

'Aty ishte edhe dikush tjetër - në një vitrinë pamë



shumë kopje të një vepre të tij. Petrescu; Nicolai Petrescu.’

‘Ah, tha ai me mprehtësi. ‘Ah, Nicolai; u takuat me Nicolai-n. Akoma i shesin librat e tij? Po ai, si është?’

Shpjegova se në të vërtetë nuk e kisha takuar. Përshkrova librarinë në Calea Victoriei, reklamën në vitrinë, dhe fotografinë e vogël në qoshe. I thashë se, me aq sa mund ta shikoja nga fotografia, dukej se ishte mirë.

‘A kishte ndonjë gjë në vrimat e kopsave? Ndonjë lloj dekorate?’

‘E keni fjalën për ndonjë lule?’

‘Sigurisht që jo. Dekoratë. Stëmë.’

I thashë se nuk e mbaja mend. Tiriac-i rivendosi trupin më thellë në divan duke vendosur gotën në mbështetësen e tij në ekuilibër të plotë.

‘Do t’ju flas për Nicolai Petrescu-n, nëse ju pëlqen.’ Ideja më pëlqeu shumë. ‘Sidoqoftë, ju nuk jeni i detyruar që patjetër t’i besoni ato që them unë, vetëm e vetëm sepse unë e njoh atë shumë mirë. Ju duhet – si është ajo shprehja që përdoret në gjueti? – duhet që të merrni shenjë pak majtas ose djathtas shënjestrës. Kësisoj duhet vepruar edhe me të vërtetën, sipas mendimit tim.

‘Nicolai dhe unë jemi moshatarë – aty te mesi i të pesëdhjetave. Moshë e re na dha mundësinë për të mos marrë pjesë në luftë, gjë për të cilën ishim mirënjohës. Të luftoje për gjermanët kundër rusëve dhe pastaj ta ndryshoje kahun e të luftoje për rusët kundër gjermanëve, siç edhe pranohet nga të gjithë, nuk ishte aspak e këndshme. Plumbat mund të vërshëllenin nga secili kah, madje edhe nga të dy kahet në të njëjtën kohë. Për fat të mirë, ne nuk qemë pjesë e asaj lufte.

Ishim rreth të tetëmbëdhjetave, apo diçka e tillë, kur ndodhi ajo që administrata e tanishme i referohet si ‘kryengritja kombëtare antifashiste dhe antiimperialiste.’ Dy burra dhe një qen, si edhe një flamur i qepur në shtëpi, plus ushtrinë vëllazërore ruse – ja, ky është kuptimi i saj. Erdhën rusët, dëbuan gjermanët, dhe hodhën një sy rreth e qark në kërkim të komunistëve vendas. Problemi ishte se nuk mundën të gjenin asnjë. A e dini sa e madhe ishte partia komuniste në Rumani në vitin 1944? Dy skuadra futbollit. Për këtë arsye, ata qëndruan për një farë kohe, ndihmuan në ndërtimin e socializmit – ose të paktën në shtimin e anëtarëve të partisë – deri sa largimi i tyre nuk përbënte më asnjë problem. Në një farë mënyre u larguan më 1947. Në një farë mënyre.

‘Në atë kohë, Nicolai dhe unë ishim studentë te politeknikumi. Ne ishim – si mund ta them këtë? – djem të mirë nga klasa e mesme. Nuk ishim fashistë apo diçka tjetër; ne thjesht nuk vinim nga klasa punëtore. Për më tepër, që të dy donim të bëheshim shkrimtarë. A e shikoni problemin?’

Pohova me kokë tek më shkoi ndër mend se ai ishte plakur shumë më mirë se Petrescu. Tiriac-i të jepte përshtypjen se ishte te dyzetë e pesat; sipas fotografisë, Petrescu tregonte mbi të gjashtëdhjetat.

‘Ma do mendja, kur bëhet fjalë për një gjë të tillë, se rruga që zgjedh shkrimtari është më shumë një çështje temperamenti sesa talenti. Gjithsesi, të paktën në një vend si i yni. Ne bisedonim gjatë për këtë temë. Natyrisht që kjo nuk ndodhte në Lidhjen e Shkrimtarëve; ndodhte vetëm midis nesh. Unë jam – si ta them, po t’ju pëlqente mund të më quanit idealist, por ndoshta problemi ka të bëjë thjesht me temperamentin tim dëshpërues. Mendoja vetëm për vështirësitë; mendoja vetëm për ato gjëra për të cilat nuk do të na lejonin të shkruanim, por jo për ato që na lejoheshin. Atëherë, isha mjaft i ashpër me çdo gjë: Besoja – pra, dhe ndoshta besoj akoma se, në qoftë se nuk mund të shkruash pikërisht për atë që do të shkruash, atëherë, nuk duhet të shkruash fare. Heshtje, ose mërgim, mund të thuash. Unë zgjodha mërgimin. Humba gjuhën, dhe gjysmën e talentit. Këto janë edhe arsyet e shumta që sot jam tepër i dëshpëruar.

‘Nicolai, hë, ai kishte një temperament të ndryshëm. Jo – nuk ishte aspak bashkëpunëtor. Ishte njeri i mirë; ishte miku im. Mbaj mend se ai ishte shumë inteligjent, i pashpresë, afërsisht në masën që isha dhe unë, por

me një mendje disi më cinike. Mbase nuk dua të them cinike – ndoshta dua të them se ai kishte humor. Unë zgjodha heshtjen dhe mërgimin; ai zgjodhi dinakërinë.

‘A e dini se çfarë është sipas tyre arkitektura e tortës së dasmës? Unë miratova me një tundje të kokës. Arkitekturë të tillë kisha parë jo pak gjatë udhëtimeve që kisha bërë në Evropën lindore. ‘Nejse, shembujt më të këqij mund t’i shihni – jashtë Rusisë, dua të them – më të mëdhatë, më të shëmtuarat, të ngritura në pozicionet më kyçe të qyteteve, janë ato që u imponuan nga Stalin-i. Quheshin dhurata të popullit sovjetik, për Varshavën, dhe kudo gjetkë. Ato janë monstrozitete. Njerëzit hidhen në anën tjetër të rrugës, dhe kur ndodhen në një vijë paralele me këto godina, pështynë me qetësi përtokë. Pastruesit e rrugës kanë më shumë punë përballë këtyre ndërtesave monstruoze që i përngjajnë tortës së dasmës, sesa në çdo pjesë tjetër të qytetit.

‘Një ditë, Nicolai përpiloi një plan për të shkruar atë çka ai e quajti romani i tortës së dasmës. Ty dy kishim qenë në një mbledhje veçanërisht të ndyrë dhe brengosëse të Lidhjes së Shkrimtarëve, pas së cilës shkuaam për një shëtitje në parkun Cismigi-u; më kujtohet që me të mbërritur në buzë të liqenit Nicolai u kthye nga unë dhe më tha: ‘Nëse kjo është ajo që ata duan, atëherë, kjo është ajo që do t’iu jap.’ Fare mirë mund ta kisha shtyrë në liqen, por a pashë tek më buzëqeshi, madje me çiltërsi. Menjëherë pas kësaj, ai filloi ta shtjellojë idenë e tij.

‘Romani i tipit tortë dasme do të luante edhe rolin e kalit të Trojës. Lëre atë jashtë qytetit e pastaj ata le ta shtynë vetë brenda; në atë mënyrë, do të jenë edhe më të kënaqur. Ja kështu Nicolai filloi punën me librin e tij. Sigurisht, ishte një libër epik: epiko-historik, epiko-sentimental, epiko-përmirësues, epiko-realist. Njëherazi, ai filloi ta marrë fjalën në mbledhjet e Lidhjes së Shkrimtarëve. ‘Kam këtë problem, shokë...’ fillonte ai, dhe i referohej romanit të tij duke shpjeguar vështirësitë që kishte hasur – për shembull, problemin e përcjelljes me realizëm të pikëpamjes së pseudo-patriotëve fashistë, ose çështjen e trajtimit të eksperiencës seksuale, pa fyer shijet e mira e të qenësishme të punëtorëve të prodhimit të çelikut në Ploesht, dashamirës dhe blerës së librit. Diçka e tillë. Luante rolin si i shqetësuar, dhe pastaj, dalëngadalë, lejonte të pagdhendurit dhe bufonët e Lidhjes që ta sillnin në ujërat e mënyrës së tyre të të menduarit, për ta çuar më tej drejt dritës. ‘Unë kam këtë problem shokë...’ Çdo herë e dëgjoja ta thoshte këtë tek mendoja se, pa dyshim, këtë radhë kanë për ta kuptuar. Në atë kohë, ama, ironia ishte një mënyrë veprimi jo shumë e njohur për komitetin e Lidhjes.

‘Kësisoj Nicolai vazhdoi me librin, dhe duke ngritur problemet që kishte me të, ai arriti të krijojë një farë frike brenda Lidhjes. Ju mund ta imagjinoni sesi janë këto punë – atyre nuk iu pëlqen që dikush të sjellë shqetësime. Nëse një shkrimtar devijon, të gjithë të tjerët rrezikojnë. Nicolai luante bukur me këtë lloj frike, dhe fakti që ai asnjëherë nuk e solli me vete librin, në një farë mënyre, i shqetësonte ata. Ai thoshte vazhdimisht se i duhej ta ripunonte atë për t’i mënjeluar gabimet përfundimtare. ‘Kam këtë problem, shokë...’

‘Ai më tregoi pjesë nga libri, ndonëse i duhej të bënte shumë kujdes, meqë mua kishin filluar të më merrnin me sy të keq. Tepër i mjerë, thonin për mua. Ato pak shkrime që dorëzova për botim u vlerësuan si të mangëta për frymëzimin e shpirtit njerëzor. Frymëzuese...hë. A thua se shkrimi është sutien, dhe shpirti njerëzor gjoks femre.

‘Nicolai ishte një shkrimtar shumë i mirë. Pjesët e librit që ai më dha mundësinë t’i lexoj ishin të mrekullueshme. Dua të them, ato ishin shumë të tmerrshme gjithashtu, por njëkohësisht edhe të mrekullueshme. Satirike nuk ishin – ai nuk donte që të vepronte me mënyra të këtilla. Ai veshi një zemër të rreme dhe më pas shkroi nga thellësia e saj. Kjo zemër e shtirë ishte tepër patriotike, sentimentale, dokumentare. Kishte shumë gjëra për faktin se populli vuante për bukë, i referohej shumë herë historisë rumune dhe qëndrueshmërisë së karakterit popullor.

Historia, natyrisht, duhej të shqyrtohej nga Lidhja. “Shokë, kam një problem tjetër të vogël...” Tani e kuptoj unë atë.’

Tek mendonte për mikun e tij Tiriac-i buzëqeshi me qesëndi; ishte një buzëqeshje e trishtuar. Kuptova se edhe kur zbavitej, me shumë lehtësi, ai merrte pamjen e një njeriu të pashpresë.

‘Ç’ndodhi më pas?’

‘Më pas ai e mbaroi librin që natyrisht e titulloi, Torta e Dasmës. Nuk ishte në gjendje t’i rezistonte tundimit për t’i vënë këtë titull librit, dhe për ta përforcuar atë, futi aty një pasazh të gjatë me simbolikën e lehtë të tortës së dasmës. Ai donte që libri të ishte si ato dhuratat e Stalinit për kombet e skllavëruara. Dëshironte që krijimi i tij të qëndronte aty, madhështor dhe jo plotësisht i admiruar në fillim, por gjithmonë i pa injoruar. E pastaj, gradualisht, me praninë e tij aty, ai do të fillonte t’i bënte njerëzit që të tregonin më shumë interes për të. Dhe sa më gjatë të qëndronte aty, sa më shumë të çmohej, aq më shumë do t’i turpëronte dhe do t’i vite në pozitë të vështirë të gjithë ata që e kishin adhuruar.

‘Unë e pyeta se çfarë do të bënte pasi libri të botohej; nëse libri do të jepte rezultate. “Nuk do të bëj asgjë,” tha ai. “Nuk do të shkruaj as edhe një fjalë të vetme. Në këtë mënyrë, shakaja do të bëhet edhe më e qartë me kalimin e viteve.” “Por, ata mund të përpiqen të të detyrojnë,” i thashë unë. “Ti e di, ata nuk i lënë njerëzit pa punë.” “Po, por deri atëherë, ndoshta do të jem bërë i famshëm. Veç kësaj, kam për t’iu thënë se tek Torta e Dasmës do të gjeni jo vetëm zemrën, por dhe gjithë shpirtin tim. ‘Nëse doni të lexoni një libër të dytë,’ do t’iu thoja unë, ‘Lexoni sërish librin e parë.’ Më pas, do të pres duke u përpjekur që të dukem si një njeri i shquar, sa më shumë që të jetë e mundur.”

‘Unë u largova nga Rumania më 1951, atëherë kur Nicolai kishte akoma shumë punë për të bërë me librin; fijet e narrativës në libër ishin rreth tridhjetë e pesë, por ato duheshin siguruar në një nyje të rregullt e të dyfishtë. Pas largimit tim, ne kurrë nuk i shkruam njëri tjetrit, sepse për të do të kishte qenë shumë e vështirë. Në vend të tij unë i shkruaja...njerëzve të parëndësishëm. Mamasë, disa miqve të padëmshëm. Siç e dini, nuk jam kthyer kurrë aty; lajme nuk kam dëgjuar për pothuajse një çerek shekulli. Në një nga letrat e saj të fundit, përpara se të ndërronte jetë, mamaja më njoftoi se Torta e Dasmës ishte botuar me një sukses të jashtëzakonshëm. Ajo nuk e kishte lexuar librin – shikimi i ishte dobësuar dhe nuk donte që atë ta keqësonte më shumë – por ajo më shkroi dhe më foli për të. “Ja mendohu,” tha ajo, “po të kishe qëndruar, Marian-i im, mund të kishe korrur suksesin që Nicolai ka korrur tani.”’

Ai u kthye nga unë, dhe ktheu një gllënjë verë. Dukej se historia e tij e kishte brengosur. Pastaj buzëqeshi.

‘Në fakt, sikur ta kisha ditur, do t’ju kisha kërkuar të më sillnit një kopje të romanit Torta e Dasmës,’ tha ai. ‘Mund të kishte qenë – çfarë? – e bukur për t’ia dhënë një të qeshure.’

‘Nuk jam i sigurt nëse ma kapi syri një kopje të tillë.’

‘...? Por, ju më thatë...në vitrinë.’

‘Jo, libri që unë pashë në vitrinë kishte vetëm emrin e një gruaje. Emanuella, Maria, diçka e tillë; dhe fotografinë e një vajze që mbante një shami mbi kokë.’ E pyeta si thuhej në rumanisht, tortë dasme; ai ma tha.

‘Sidoqoftë, ky titull nuk më kujtohet. Duhet të kenë qenë gjashtë ose shtatë tituj të tjerë të Petrescu-t, por që unë nuk i vështrova me kujdes. Mundet që edhe ai titull të ketë qenë aty.’

Pastaj pushuam të dy, vështruam njëri tjetrin, dhe qëndruam të heshtur. Atë që ai po mendonte, unë munda ta përfytyroj.

‘Mirë,’ tha ai më në fund. ‘Ja tek e keni. Dëshminë tjetër për teorinë tuaj rumune. Një lule tjetër e vetme. Një shkrimtar i madh i ironisë - Petrescu.’

‘Natyrisht,’ u përgjigja unë pa vonesë tek i dhurova buzëqeshjen time më kuptimplote.

*Përktheu: Aristidh Shqevi
Oslo, 19.11.2020*

"KUR ËSHTË FJALA PËR KOMBIN E VET, KADAREJA ËSHTË PO AQ I VERBËR SA HOMERI"

Keqkuptimi i kritikut francez për romanin "Dosja H"

nga Skënder KARRIQI

Në esenë "Lexues tepër seriozë të botës, kini kujdes!", nobelisti i vitit 1976 Saul Bellow, ndër të tjera, sjell detaje mbi profilin e njërit prej këtyre lexuesve tepër seriozë të botës: studentit që, pasi e kishte një mendim, pyet profesorin e vet se pse Akili e tërheq zvarrë Hektorin rreth mureve të Trojës. Duke nuhatur se studenti mund të kishte diçka përtej përgjigjes së rëndomtë që lidhej me zemërimin e Akilit, profesori i jep mundësi atij të shprehet, duke i thënë se pyetja që sapo bëri tingëllonte nxitëse dhe ia vlente të diskutohej. Kështu, profesori i dha udhë përgjigjes së vetë studentit, e cila, përtej zemërimit, veprimin e heroit tipik të periudhës heroike e motivonte me faktin se Iliada ishte plot me rrathë, mburoja, rrota qerresh dhe figura të tjera të rrumbullakta, duke e argumentuar mendimin e vet me referenca nga Platoni mbi rrathët dhe prirjen greke për gjeometri. Homeri, shprehet studenti, është përherë në nivelin e Platonit dhe, nëse Platoni ka atë mendim për rrathët, Homeri me siguri duhet të ketë përcjellë mendimin e vet, duke shpërfaqur të njëjtin mendim po aq bukur, rreth pas rrethi.

Në fakt Bellow, ky lexues tepër serioz dhe i kujdesshëm i botës, e çon mendimin tonë tek miti i verbërisë së Homerit, mit i cili, nga lexues joseriozë të botës, besohet si një fakt historik dhe biografik. Përtej këtij leximi të pakujdesshëm të botës, (mitit të verbërisë së Homerit në rastin tonë) Bellow na jep mundësinë të kuptojmë se ai, aedi antik ishte konceptuesi i parë i botës, në atë kuptim ideal absolut (gjeometrik, po deshët ju), të cilin Platoni do ta filozofonte shekuj më vonë, sigurisht, jo jashtë konsideratave për veprën e Homerit, e cila e shenjonte si një dominante, edhe filozofike, horizontin letrar dhe kulturor të kohës.



Për konceptuesin e parë të idesë absolute (Homerin) apo botës së ideve (Hegeli), miti mbi verbërinë legjitimon në botën euklidiane (tripërmasore) të vërtetën e sublimes homerike, e cila nuk është e vërteta e parë me sy, por e vërteta konceptuale e asaj që kishte ndodhur 12 shekuj më parë, përndryshe, e vërteta sipërane, e kulluar prej mishërimeve tokësore. Pra, përtej faktit arketipal të verbërisë së Homerit, miti i tij legjitimon institucionin e aedit, i cili tejkalonte kohën dhe hapësirën e vet, për të qenë banor i gjithëkohësisë dhe gjithëhapësisë. Në këtë kuptim, të konsideruarit e verbërisë së Homerit si fakt historik dhe biografik shkakton keqkuptime (dramatike, siç thotë Kadareja për një rast që do ta shjellojmë më poshtë) në leximin serioz dhe të kujdesshëm të botës.

Në librin e tij "Dialog me Alain Bosquet", Ismail Kadare, ndër të tjera, sjell edhe rastin e një lexuesi joserioz të botës, rast ky që ka të bëjë me një kritik francez, të cilit ai (I.K.), kur jepte intervistën për Bosquet, nuk ia mbante mend emrin. Kritiku francez, pasi kishte lexuar romanin Dosja H dhe ishte tepër admirativ për veprën, në mënyrë tepër të sinqertë, shkruajti një artikull me titullin e gjatë: Kur është fjala për kombin e vet, Kadareja është po aq i verbër sa Homeri, duke shprehur në të keqardhjen për cenin nacionalist, që, sipas tij, ishte një dominante në romanin e sipërpërmendur. Duket qartë se kritiku francez, me premisë krahasimtare leximin e pakujdesshëm dhe joserioz të mitit të verbërisë homerike, bën një lexim tjetër të pakujdesshëm dhe joserioz në lidhje me romanin "Dosja H". Dhe kështu, koncepti i tij për nacionalizmin është sa tokësor e i gabuar, aq edhe naiv, ballkanik e me shenja të kundërta kuptimore, sa,

duke u shpjeguar në "Dialog me Bosquet", Kadareja e quan atë një keqkuptim vërtet dramatik. Në fakt, siç edhe shpjegohet vetë autori i "Dosja H", kur atij ia jep këtë mundësi Alain Bosquet përmes intervistës nacionalizëm nuk është kur e do fort popullin tënd, por kur nuk i do e nuk i duron dot popujt e tjerë. Kështu, në dialog e sipër, për ta mbrojtur nga lexues joseriozë dhe të pakujdesshëm të botës, qoftë ky edhe një kritik francez, admirativ dhe tepër i sinqertë, që boton në revista prestigjioze franceze, Kadaresë i duhet t'i bëjë një shërbim plus romanit të vet "Dosja H", duke sqaruar për kritikun francez dhe për të gjithë lexuesit e mundshëm të pakujdesshëm konceptin e nacionalizmit në kundërvënien me patriotizmin.

Sipas një kronologjie, le të themi normale (Homeri, Platoni, Kadareja, Pamuku) duke abstraguat hapësirën shekullore ndërmjet antikëve dhe modernëve, nobelisti turk risjell në mënyrën e tij, por edhe në përputhje me faktin historik, motivin e verbërisë homerike ose, më mirë, hijen e tij, nëpërmjet romanit të mirënjohur Unë jam e kuqja. Ndër të tjera, aty nobelisti turk sjell edhe figurën e Kryemjeshtrit piktor të Oborrit Sulltanor që, përtej doktrinës së vet ikonoklaste, merr urdhërin e fshehtë për të realizuar portretin e Perandorit Romak sipas stilit perëndimor (joikonoklast). Në portretizim e sipër të Kryemjeshtrit të Oborrit Sulltanor, Pamuku e sheh tepër të arsyeshme dhe të domosdoshme të theksojë detaje të protokollit oborrtar të legjitimitetit të titullit dhe statusit të Kryemjeshtrit oborrtar. Ishte i denjë për ta fituar këtë status ai piktor që, në përvojë e sipër, kishte arritur në nivelin e verbërisë, pothuajse natyrale. Sytë e tij ishin rudimentuar si shenjë e sigurt e marrëdhënies permanente jo me botën tokësore, këtë hapësirë të kufizuar euklidiane, ku ideja absolute mishërohej në gjësende dhe, për këtë arsye, në pasqyrim e sipër, duhet të perceptohej në mënyrë optike, e parë me sy dhe jo e menduar konceptualisht, si një ide absolute.

Kështu, shekull pas shekulli, miti i verbërisë homerike është rimarrë nga shkrimtarët, duke na sugjeruar alternativën sipërane të tij, si rrugën e sigurt për të arritur tek e vërteta e kulluar dhe për të shmangur një kuptim naiv apo, aq më keq, një keqkuptim vërtet dramatik, qoftë ky lexues joserioz edhe një kritik francez që, për fat të keq, beson në verbërinë faktike të aedit antik, Homerit.





TREGIM PAS TREGIMIT

Nga Gabriel Garsia Marquez

Klotilde Armenta, që është një nga personazhet e romanit tim “Kronikë e një vrasje të paralajmëruar”, në një pjesë të librit thërret papritur: “O perëndia ime! Sa të vetmuara jemi ne gratë në këtë botë!”

Rosana Rosanda, një nga qeniet njerëzore më inteligjente që kam njohur, në një intervistë për shtypin, më pyeti se si kisha arritur unë në një konkluzion të tillë. “Nga e di ti këtë?” qe pyetja e saj konkrete. Asnjë gazetar nuk më ka vënë aq shumë në mendime, për sjelljen e njërit prej personazheve të mi. Mbi të gjitha, askush si ajo, në këtë rast, nuk më ka detyruar të mendoj aq seriozisht për rolin e grave në librat e mi – dhe njëherësh edhe në jetën time – gjë kjo për të cilën shumë kritikë kanë folur e shkruar, jo vetëm më tepër nga sa duhet, por edhe më shumë nga sa dinë.

Personazhi i Klotilde Armentas, që nuk ka ekzistuar në realitet, ishte tërësisht fryt i imagjinatës sime. E bëra këtë, sepse më mungonte një kundërpeshë për Pura Vikarion, nënën e protagonistes kryesore. Karakterin e Klotilde Armentas unë e ndërtova pak nga pak, gjatë procesit krijues, në përshtatje me dredhat e papritura të dramës që po ndodhte. Intuuta më thoshte se krimi nuk mund të ndalohej, sepse realisht, në jetë, nuk ekzistonte një grua si ajo, por në ndonjë moment u përpoqa që, të paktën, ta ndaloja krimin në librin tim. Megjithatë, në çdo hap më shkonte mendja se e vetmja gjë që ajo mund të bënte për ta prapsur kryerjen e krimit, ishte të kërkonte ndihmën e dikujt tjetër. Dhe thujse gjithmonë këta “të tjerë” ishin burra. Ishte ky një realitet jo vetëm brenda imagjinatës sime krijuese,

por edhe në kushtet sociale të vetë popullit. Në kulmin e dramës, unë arrita të zbuloj, - dhe sytë m’u errën nga ky ndriçim i së vërtetës, - se pikërisht brenda këtyre kushteve zinin fill rrënjët e pafuqishmërisë së Klotilde Armentas për të parandaluar krimin. Atëherë ajo thirri: “O perëndia ime! Sa të vetmuara jemi ne gratë në këtë botë!”. Nuk e thashë unë, e tha ajo, megjithëse qe diçka e vështirë për t’u kuptuar nga ndonjë tjetër, që nuk është shkrimtar. E pra, besoj se unë dhe ajo e zbuluam njëherësh këtë të vërtetë. Dhe sapo e zbuluam, kuptuam se ishte një gjë që e dinim prej kohësh, por nuk kishim arritur ta shpjegonim. Ishte kjo përgjigja që i dhashë gazetares për intervistën.

Një nga lexuesit e parë të romanit më ka thënë: “Kjo nuk është gjë tjetër përveçse një punë e fëlliqur e grave”. Një tjetër u përpoq të më mbushte mendjen se romani im kishte një dramë të të rinjve, meqë asnjë prej protagonistëve nuk ishte më shumë se njëzet e pesë vjeç. Dhe ky lexues besonte se kishte kuptuar që libri ishte një provë se praagjykimet e të rriturve përcaktonin rrjedhën e tragjedisë. Në çdo rast, unë kisha bindjen se ishte pjesëmarrja e grave ajo që vendoste zhvillimin e ngjarjeve. Personazhi që komandonte dramën, që nga skutat e errëta, ishte Pura Vikario, nëna e Anhelës – gjë që nuk ka ndodhur, sigurisht, në realitet – dhe nuk besoj se këtë e bënte nga ndonjë shtysë qiellore, por sepse mendonte që familja nuk ishte në gjendje të përballonte përzënie shoqërore, nëse djemtë e saj nuk do ta lanin turpin me gjak. Anhela Vikario e zbuloi këtë të vërtetë shumë

më vonë, në hotelin e portit të Rioaçës, kur u kthye të shikonte burrin që e braktisi. Atëherë ajo kuptoi që e dashuronte ende e mbi gjithçka, por njëkohësisht kuptoi se nëna ishte përgjegjëse e vetme e fatkeqësisë. Dhe e pa nënën e saj ashtu siç ishte: “Një grua e mjerë, e përkushtuar ndaj kultit të ceneve të veta”. Në çdo rast, sipas pikëpamjes sime, ajo që zbulon më qartë padrejtësinë dhe tërë mjerimin e asaj shoqërie, ishte fakti që gruaja më e lirë në roman, dhe në realitet e vetmja grua e lirë, ishte Maria Alehandrina Servantes, një putanë e madhe.

Aspekt tjetër që i interesonte gazetares ishte përzierja e fatalitetit me dramën. Në të vërtetë, asnjëherë nuk më ka interesuar rastësia si faktor përcaktues. Ajo që duket si rastësi në romanin “Kronikë e një vrasjeje të paralajmëruar” nuk është tjetër veçse një element mekanik i të treguarit të ngjarjeve. Po ashtu si edhe te “Edipi mbret” i Sofokliut – megjithëse duket e çuditshme në një tragjedi greke – thelbi i së cilës nuk është fataliteti apo rastësia e bëmave, por vetë drama e njeriut, në kërkim të fatit dhe të identitetit të tij.

Në romanin tim përpjekja kryesore ka qenë zbulimi dhe njohja e asaj serie të pafundme të koincidencave të vogla e të lidhura si në një vargua, të cilat brënda një shoqërie si e jona, bënë të mundur kryerjen e një krimi të tillë absurd. Gjithçka ishte e evitueshme. E pra ishte kondicioni shoqëror, mënyra e jetesës, ajo që duhej ndaluar dhe shmangur e jo “fatumi”. Rosana Rosanda jo vetëm që ishte në një mendje me mua, por, në të njëjtën kohë, ajo deshifroi edhe enigmën shqetësuese: “Kjo nuk është drama e fatalitetit, - më tha, - por drama e përgjegjësisë. Akoma më tej: drama e përgjegjësisë kolektive. Unë besoj, gjithashtu, se romani, arrin ta çmitizojë fatalitetin dhe tregon se ne vetë jemi të vetmit zotër të fatit tonë”.

E gjithë kjo më duket edhe më e spikatur, sa herë që kujtoj atë ditë fatkeqe, kur ngjarja ndodhi në realitet. Unë nuk isha dëshmitar në ngjarje, por e njihja shumë mirë vendin, i njihja shumë mirë pjesëmarrësit. Kujtoj se, kur mora vesh lajmin dhe të gjitha hollësitë e tij, u tërbova nga zemërimi sepse, sa herë i kthehesha e i rikthehesha ngjarjes, çdo gjë më dukej e shmangshme.

Qysh atëherë, te të gjithë dëshmitarët, të cilët i kam pyetur vite me radhë se si ndodhi që ata vetë nuk mundën ta ndalojnë krimin, kam parë gjithnjë të njëjtën dëshirë për të justifikuar çdo veprim të vetin në atë ditë krimi. Aq e vërtetë është kjo, sa që unë përherë kam besuar se në këtë dëshirë të tyre duhej hapur ndjenja e sigurt e fajit. Unë besoj se ajo që i paralizoi të gjithë, ishte mendësia e vetëdijshme ose e pavetëdijshme se ai krim ritual ishte një akt i kërkuar nga vetë shoqëria.

Rrethanat në të cilat Bojardo San Romani u martua përsëri me gruan e përzënë nuk ishin të njëjta si në libër. Duhet të pranoj se, në këtë rast, realiteti ishte më domethënës. Gjithçka erdhi si një thashethemnajë që qarkulloi mes dëshmitarëve të ngjarjes. Sipas kësaj pëshpërime që u përhap, burri kishte bërë të gjitha llojet e përpjekjeve që të rikthehej te gruaja e përzënë, por ajo nuk desh të pranonte. Pa dyshim, koha nuk kishte kaluar me të njëjtën shpejtësi e me të njëjtin intensitet për të dhe burrin e saj. Por ajo që më interesoi atëherë ishte se përpjekja e pajtimit, e krijuar në pëshpërimat e dëshmitarëve të ngjarjes, u përhap me shpejtësi të madhe midis tyre. Dhe vetë këta e përhapën sikur të qe një gjë e kryer e sikur bashkëshortët e ndarë ditën e dasmës, qenë ribashkuar dhe kështu do të jetonin përgjithnjë e tejet të lumtur. Të gjithë, pra, e ndienin nevojën e këtij ribashkimi, sepse do të ishte si një fund i fajit kolektiv, do t’u dukej se ajo fatkeqësi, për të cilën të tërë ishin fajtorë, do të fshihej fare e përgjithnjë nga kujtesa shoqërore. Por ja që gjithnjë del një plangprishës, funksioni i vetëm i të cilit, në këtë botë, është të kujtojë atë që të tjerët përpiqen ta harrojnë.

Përktheu nga spanjishtja
NAMIK DOKLE



MARGARET ATWOOD

DISTOPIA E HARRUAR QË FRYMËZOI GEORGE ORWELL-IN DHE MUA

Nuk e lexova romanin e shquar të Jevgenij Zamjatin (Yevgeny Zamyatin), “Ne”, deri në 1990, shumë vite pasi kisha shkruar “Rrëfenja e shërbëtores”. Si mund të më kishte shpëtuar pa lexuar një nga distopitë më të rëndësishme të shekullit të 20 me ndikim të drejtpërdrejtë në romanin “1984” të George Orwell-it, i cili pati ndikim të drejtpërdrejtë tek unë?

Mbase më shpëtoi pa lexuar sepse isha lexuese e Orwell-it por jo studiuese e Orwell-it, dhe lexuese e letërsisë fantastiko-shkencore por jo studiuese e letërsisë fantastiko-shkencore. Kur më në fund u ndesha me “Ne”, më mahniti. Dhe tani që po e lexoj sërish përkthimin e ri dhe të shkëlqyer të Bela Shayeich-it, sërish po më mahniti.

Tek romani “Ne” kaq shumë gjëra ngjajnë profetike: përpjekja për ta zhdukur individin duke i bashkuar të gjithë qytetarët me shtetin; mbikëqyrja e pothuajse çdo veprimi dhe mendimi, pjesërisht përmes veshëve magjepsës gjigant rozë që dëgjojnë çdo thënie. Likuidimi i kundërshtarëve - në shkrimet e Leninit të vitit 1918, ky likuidim ishte metaforik, por tek “Ne” është i fjalëpërfjalshëm, pasi ata që duhet të likuidohen në të vërtetë shndërrohen në lëng; ngritja e një muri kufitar që nuk shërben thjesht për të parandaluar pushtimin por për t’i mbajtur brenda qytetarët; krijimi i Mirëbërësit të Madh Vëllazëror, më i madh se jeta, i gjithëdijshëm, i krye-urti i cili mund të jetë thjesht imazh ose simulakrum - të gjitha këto detaje paralajmëruan gjërat që do të vinin.

Kështu bëri edhe përdorimi i shkronjave dhe numrave më shumë sesa i emrave: kampet e shfarosjes së Hitlerit nuk kishin damkosur ende numra tek banorët e tyre dhe ne të kësaj epoke nuk ishim bërë ende ushqim për algoritmet. Stalini ende nuk kishte farkëtuar kultin e personalitetit të tij, Muri i Berlinit ishte dekada në të ardhmen, përgjimet

elektronike nuk kishin marrë trajtë, gjyqet publike të Stalinit dhe spastrimet massive nuk do të ndodhnin edhe për një dekadë - megjithatë këtu është plani i përgjithshëm i diktaturave të mëvonshme dhe kapitalizmit të mbikëqyrjes, e paraqitur tek “Ne” si në një projekt.

Zamjatin po shkruante “Ne” në vitet 1920-21, ndërsa lufta civile që pasoi Revolucionin e Tetorit të mbizotëruar nga bolshevikët ishte ende në proces. Vetë Zamjatin, kishte qenë anëtar i lëvizjes para vitit 1905, ishte bolshevik i vjetër (një grup i planifikuar për likuidim nga Stalini në vitet 1930 sepse ata nuk hoqën dorë nga ideat e tyre fillestare demokratike-komuniste në vend që të mbështesnin autokracinë e shokut Stalin) - por tani që bolshevikët po e fitonin luftën civile, Zamjatin s’i pëlqente mënyra se si po zhvilloheshin ngjarjet. Komitetet fillestare të komunave thjesht po vulosnin pushtetin e elitës që u shfaq nën Leninin dhe do të forcohej nga Stalini. A ishte kjo barazi? A ishte ky lulëzimi i dhuntive dhe talenteve të individit që ishin propozuar në mënyrë kaq romantike nga partia më herët?

Në esenë e vitit 1921 “Kam frikë”, Zamjatin tha: “Letërsia e vërtetë mund të ekzistojë vetëm kur krijohet, jo nga zyrtarë të zellshëm dhe të besueshëm, por nga njerëz të marrë, vetmitarë, heretikë, ëndërrimtarë, rebelë dhe skeptikë”. Më këtë pikëpamje ai ishte fëmijë i lëvizjes romantike, siç ishte vetë revolucioni. Por “zyrtarët e zellshëm dhe të besueshëm”, pasi panë se nga frynte era Leniniste-Staliniste, kishin nisur tashmë të instalonin censurën, duke lëshuar dekrete për tema dhe stile të parapëlqyera dhe duke shkukur barërat e këqija joortodokse. Kjo gjithmonë është praktikë e rrezikshme në totalitarizëm, pasi ka të ngjarë që barërat e këqija dhe lulet t’i ndryshojnë vendet sapo një autokrat të hap e mbyll sytë.

“Ne” mund të shihet pjesërisht si utopi: qëllimi i Shteti të Njëshit është lumturia universale dhe argumenton që nuk mund të jesh edhe i lumtur edhe i lirë, liria duhet të zhduket. “Të drejtat” për të cilat njerëzit debatojnë kaq shumë në shekullin e 19-të (dhe për të cilat vazhdojnë të debatojnë kaq shumë edhe tani) shihen si qesharake: nëse Shteti i Njëshit ka gjithçka nën kontroll dhe po vepron për lumturinë më të madhe të mundshme të të gjithëve, kush paska nevojë për të drejta?

Kemi parë një varg të gjatë utopish të shekullit të 19-të që gjithashtu propozuan receta për lumturinë universale. U shkruan kaq shumë utopi letrare në shekullin e 19-të, sa që Gilbert dhe Sullivan krijuan një parodi operistike me titull “Utopia, e kufizuar”. Disa nga pikat kryesore janë Gara e Ardhjes së Bulwer-Lytton-it (një racë njerëzore superiore që jeton në Norvegji, me teknologji të përparuar, krahë të fryrë, arsye që e kontrollojnë pasionin, dhe femrat që janë më të mëdha dhe më të forta se meshkujt); “Lajme nga Askund” e William Morris-it (socialist dhe partizan i barazisë, i arteve dhe zanateve, veshjeve artistike dhe çdo femër që të ngjall mahnitjen para-Rafaelite); dhe “Epokë kristali” nga W. H. Hudson-i, ku njerëzit jo vetëm që kanë bukuri dhe veshje artistike, por jepen të lumtur, si Shakers (Shoqata Amerikane e Besimtarëve në Ardhjen e Dytë të Krishtit), por sidoqoftë duke mos pasur asnjë interes për seksin.

Shekulli i vonë i 19-të ishte idengulitur me “problemin e gruas” dhe “gruan e re”, dhe asnjë utopi apo distopi vetme nuk mund të shmangte traditën ekzistuese për seksin. As Bashkimi Sovjetik. Përpjekjet e hershme për të zhdukur familjen, për t’i rritur fëmijët kolektivisht, për të lejuar divorcin e menjëhershëm dhe, në disa qytete, për ta dekretuar si krim nëse një grua refuzon të bëjë seks me një komunist mashkull (ide brilante, djema!) krijuan një farsë

dhe kaos aq mjeran sa Stalini u tërhoq menjëherë me tërbim nga kjo politikë në vitet 1930.

Por Zamjatini po shkruante në periudhën e hershme, atë të fermentimit, dhe janë këto qëndrime dhe politika që satirizon “Ne”. Megjithëse njerëzit jetojnë në shtëpi mirëfilli prej xhami, me të gjitha veprimet e tyre transparente, ata ulin grilat modeste për orën e seksit, orë e rezervuar paraprkasht me biletë rozë dhe të regjistruar siç duhet nga një grua e moshuar në holl të çdo ndërtese apartamentesh, sipas rregullores. Por megjithëse të gjithë bëjnë seks, vetëm gratë që plotësojnë disa specifikime fizike lejohen të kenë fëmijë: eugjenika u konsiderua “përparimtare” në këtë kohë.

Ashtu si tek romani i Xhek Londonit, 1908, “Thundra e hekurt” një distopi që shpreson për një të ardhme utopike, dhe gjithashtu tek “1984” e Orwell-it, forcat lëvizëse të kundërshtimit tek “Ne” janë femra. D-503, protagonist mashkull, në fillim është anëtar i përkushtuar i Shtetit të Njëshit, duke u përgatitur të lëshoj një raketë në univers me qëllim që të shpërndajë në botë të panjohura recetën e Shtetit të Njëshit për lumturinë e përsosur. Personazhet distopik priren të shkruajnë ditar, dhe D-503 synon të shkruaj ditarin e tij për universin. Por subjekti ndërlikohet, dhe po kështu edhe proza e D-së. A zhytet në atmosferë tipike për Edgar Allan Poe-n në çastet më të çuditshme? Ose në atmosferën romantike gotike gjermane? Apo si tek Baudelaire? Ndoshta. Ose ky është stili i këtij autori.

Shkaku i kësaj shkundje emocionale është seksi. Sikur D të mbetej tek takimet e planifikuara seksuale dhe biletat e tij rozë! Por s’mundet. Hyn tek I-330, një disident sekret këndor, individualist bohem dhe që pi alkool, i cili e josh në një fole të fshehtë dashurie dhe e bën të vërë në pikëpyetje Shtetin e Njëshit. Ajo përbën kontrast të madh me O-90, një grua e rrumbullakët, e bindur që e ka të ndaluar të ketë fëmijë, sepse është shumë e shkurtër dhe është partnerja seksuale biletë-rozë e D-së. O-ja mund të interpretohet si rreth – përmbushje dhe plotësi - ose si zero e zbrazët, dhe Zamjatini i zgjedh të dyja. Në fillim mendojmë se O-90 nuk vlen për asgjë, por kur mbetet shtatzënë pavarësisht vetos zyrtare, na befason.

Shumë është shkruar për ndryshimin midis kulturave të Unë dhe kulturave të Ne. Në një kulturë të Unë siç janë Shtetet e Bashkuara, individualiteti dhe zgjedhja vetjake janë pothuajse fe. Asgjë s’është rastësi: Amerika e ka fillesën tek puritanët dhe në fenë protestante është i rëndësishëm shpirti individual përballë Zotit, jo anëtarësia në një kishë universale. Puritanët ishin shkrimtarë të mëdhenj të ditarëve, ku regjistronin çdo shmangie dhe gabim shpirtëror: duhet të besosh në vlerën e lartë të shpirtit tënd për ta bërë këtë. “Gjej zërin tënd” është një mantra në kurset e shkrimit në Amerikën e Veriut, dhe kjo do të thotë gjej zërin tënd unik. “Fjala e lirë” do të thotë që ti mund të thuash gjithçka që të pëlqen.

Në kulturat e Ne, për çfarë të hyn në punë ai lloj zëri? Është të qenët pjesë e një grupi ajo që vlerësohet: duhesh të veprosh në interes të harmonisë shoqërore. “Fjalë e lirë” do të thotë që ti mund të thuash gjithçka që të pëlqen, por ajo që të pëlqen natyrshëm do të kufizohet nga efektet që mund të ketë tek të tjerët, dhe kush do ta përcaktojë këtë? Vullneti i “ne”. Por kur bëhet “ne” një turmë? A është ëndërr apo makth përshkrimi i D-së për të gjithë ata që bëjnë një shëtitje me hap rreshtor, të unifikuar? Kur kthehet kjo “ne” kaq harmonike, dhe kaq e unifikuar në një tubim nazist? Kjo është qendra e zjarrit kulturor në të cilin e gjejmë veten sot.

Çdo qenie njerëzore është me siguri edhe një Unë, i veçantë, i dallueshëm, edhe një Ne, pjesë e një familjeje, një vendi, një kulture. Në botën më të mirë, Ne – grupi, vlerëson Unë për veçantinë e tij, dhe Unë e njeh veten përmes marrëdhënieve me të tjerët. Nëse ekuilibri kuptohet dhe respektohet - ose kështu priremi të besojmë - nuk ka nevojë të ketë konflikt. Por Shteti i Njëshit ka prishur ekuilibrin: është përpjekur ta shfarosë Unë, i cili megjithatë këmbëngul pareshtur. Prandaj kemi vuajtjet e pakëta të D-503. Debatet e D-së me veten janë debatet e Zamjatinit me konformizmin e shfaqur dhe mbytjen e zërit që ekzistonte në fillim, në BS. Çfarë po ndodhte me vizionin e ndritshëm që predikonin utopitë e shekullit të 19-të dhe në të vërtetë vetë komunizmi? Çfarë kishte shkuar kaq keq?

Kur Orwell-i shkroi 1984, spastrimet dhe asgjësimet e Stalinit kishin ndodhur tashmë, Hitleri kishte ardhur dhe shkuar, dihej shkalla në të cilën një person mund të zvogëlohej dhe shtrembërohej si qenie nga torturat, kështu që vizioni i tij është shumë më i errët se ai i Zamjatinit. Dy heroinat e Zamjatinit janë të patundura, ashtu si të Jack

London-it, ndërsa Julia e Orwell-it kapitullon dhe tradhëton gati menjëherë. Personazhi i Zamjatinit S-4711 është operativ i shërbimit sekret, por numri i tij mishëron alter egon e tij. 4711 është emri i një kolonje që filloi të përdoret në qytetin gjerman të Këlnit (Cologne), ku në vitin 1288 u organizua një revoltë e suksesshme demokratike kundër autoriteteve të kishës dhe shtetit dhe ai u bë Qytet i Lirë Perandorak. Po, S-4711 është në të vërtetë disident, i vedosur për revoltë. Ndërsa në 1984, O’Brien shtiret si disident, por në të vërtetë është anëtar i policisë së shtetit.

Zamjatini merr parasysh mundësinë e arratisjes: përtej Murit është një botë e natyrshme ku ka qenie njerëzore të lira “barbare”, të mbuluara me – mos vallë me gëzof? Për Orwell-in, askush në botën e “1984” s’mund të largohet nga ajo botë, megjithëse lejohet një e ardhme e largët në të cilën kjo shoqëri nuk ekziston më.

“Ne” u shkrua në një moment të veçantë të historisë, atëherë kur utopia e premtuar nga komunizmi po zbehej në distopi; atëherë kur, në emër të bërjes së të gjithëve të lumtur, heretikët akuzoheshin për krim mendimi, mosmarrëveshja

me një autokrat barazohej me mosbesnikërinë ndaj revolucionit, gjyqet publike po përhapeshin dhe asgjësimi i kundërshtarit ishte bërë rendi i ditës. Si mund ta kishte parë Zamjatini të ardhmen kaq qartë? Nuk e bëri, sigurisht. Ai pa të tashmen, dhe atë që tashmë fshihej në hijet e saj.

“Drejtimi që ndjek njeriu bën që ti të parashohësh se ku po synon të shkojë, synime të cilat, nëse ngulmohen, arrihen”, thotë Ebenezer Scrooge në “Kënga e Krishtlindjeve” të Dickens-it (1984). “Por nëse ata ndërrojnë drejtim, synimi ndryshon”.

“Ne” ishte paralajmërim për vendin dhe kohën e vet, një paralajmërim që nuk u mor parasysh sepse nuk u dëgjua: “zyrtarët e zellshëm dhe të besueshëm” u morën më së miri me këtë. Drejtimi u ndërrua. Qindra milionë njerëz vdiqën.

A është edhe një paralajmërim për ne, në kohën tonë? Nëse po, çfarë lloj paralajmërimi? A po e dëgjojmë?

The Telegraph, 4 nëntor 2020

Përktheu: GRANIT ZELA



**LULJETA
LLESHANAKU**

poezi të zgjedhura

Onufri